


MUNGESA E BOTËKËPTIMEVE TË MODERIMIT NË UNIVERSITETET ARABE



Dr. Hajredin Hoxha

Prof.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**MUNGESA E BOTËKÛPTIMEVE
TË MODERIMIT NË
UNIVERSITETET ARABE**

**Lexim mbi përvojën edukative japoneze dhe mbi interesimin e
Mbretërisë Saudite për të**

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Dr. Hajredin HOXHA

**MUNGESA E BOTËKUPTIMEVE TË MODERIMIT
NË UNIVERSITETET ARABE**

Lexim mbi përvojën edukative japoneze dhe mbi
interesimin e Mbretërisë Saudite për të

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:
Sedat ISLAMI

Recensoi: Ajni Sinani
Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Titulli në origjinal:

Dr. Hajruddin Huxheh,

*El-Meani el-mugajjebh li-l-vesatijjeti fi-l-xhamiaati-l-arabijeh,
Kiraetun fi-t-texhribeti-t-ta'limijjeti-l-jabanijeh ve'htimami-l-
Memleketi-l-Arabijjeti-Suudijjeti biha, referim shkencor i përgatitur
për seminarin ndërkombëtar "Ta'zizu-l-vesatijjeti fi-l-Xhamiaati-l-
Arabijeh", të organizuar nga Universiteti Tajjibeh në bashkëpunim
me Muxhemme' el-Melik Fehd, për botimin e Kur'anit në Medine
Munevvere, 15-17 mars 2011.*

Dr. Hajredin HOXHA

**MUNGESA E BOTËKUPTIMEVE TË MODERIMIT
NË UNIVERSITETET ARABE**

Lexim mbi përvojën edukative japoneze dhe mbi
interesimin e Mbretërisë Saudite për të

Përmbledhje

Autenticiteti është i nevojshëm për çdo popull, e në veçanti për popujt muslimanë. Autenticiteti bazohet në Kur'an, Sunnet dhe jetëpërshkrimet e paraardhësve tanë të sinqertë (selefu-s-salih) ndërsa nënkupton kthimin e ummetit tek rrënja, tek zanafilla, ngase ummeti shquhet për misionin, rolin dhe rëndësinë që ka. Kështu, autenticiteti synon të njoftojë bijtë e ummetit me fenë e tyre, sikurse që i vë vetes për obligim t'i ruajë ata nga sulmet e armiqve. Ummeti – falë ndihmës së Allahut – shquhet për fenë, metodologjitë, rregullat dhe dispozitat; ai është ummet mesatar dhe dëshmitar për ummetet e tjera. Megjithëkëtë, autenticiteti – siç kanë pohuar njëzëri dijetarët – nuk nënkupton apriori refuzimin e tërësishëm të të tjerëve. Në të vërtetë, qëndrimi i muslimanit, karshi kulturave dhe përvojave të të tjerëve, mund të specifikohet ndërmjet pranimit dhe refuzimit në këto katër rastet në vijim:

1. Pranimi i tërësishëm ose *qëndrimi i pranimit dhe shkrirjes*,
2. Refuzimi i tërësishëm ose *qëndrimi i refuzimit dhe shkëputjes*,
3. Pranimi i të dëmshmes dhe refuzimi i të mirës ose *qëndrimi i shkëputjes, tjetërsimit dhe rënies në humnerë*, dhe
4. Pranimi i së mirës dhe refuzimi i të dëmshmes ose *qëndrimi i veçimit dhe përfitimit*.

Sigurisht se qëndrimi më i qëlluar është ky i fundit, dhe kjo është ajo për të cilën shquhet ummeti. Në fakt, ky qëndrim mesatar dhe i matur e ka bërë këtë ummet misionar dhe udhëzues, ummet këshillues dhe prijatar, ummet vlerësues dhe dëshmues...

Dijetarët kanë përmendur shumë domethënie të mesatares (*el vesatijeh*), si: *'baraspeshim dhe barazi; program integruar; argument humanizmi dhe imazh nderi dhe veçimi; siguri dhe largim nga rreziqet; argument dhe qëndër force; qëndër unifikimi dhe pikë bashkimi...'*

Konsideroj se nuk ka gjë të keqe nëse mesatares i shtojmë, në këtë kontekst, edhe disa kuptime apo domethënie të ngjashme apo përfaqëse me këto që përmendëm, si: *'përsosmëri, shpikje dhe zbulim.'* Që të jesh i fortë, i dalluar dhe udhëzues për të mirën të të tjerët gjithsesi se duhet t'i kryesh

punët me përsosmëri, duhet të kesh ide origjinale dhe aftësi për prodhimin e tyre.

Aplikimi i këtyre domethënieve të mesatares sigurisht se do të jepte rezultate në të gjitha nivelet e ummetit: shkencor, edukativ, arsimor, moral, ekonomik, politik, kulturor, teknologjik, por, për fat të keq, ummeti ka dështuar në realizimin e këtyre botëkuptimeve të mesatares dhe objektivave të saj, kështu që nevoja për një rishikim, vetëkritikë dhe përfitim nga eksperiencia e universiteteve botërore mbetet si nevojë imediate e tij për të ruajtur veten dhe studentët nga rrjedhat që mund të kenë epilog tragjik dhe pasoja të mëdha.

Ky punim mëton të hedh dritë mbi përvojën edukative arsimore të Japonisë, për të zbuluar sekretin e këtij suksesi dhe kësaj epërsie të studentëve dhe profesorëve në shkollat dhe universitet e tyre. Po ashtu, punimi pretendon të zbulojë edhe raportet e kësaj eksperience me këto botëkuptime të zhdukura të mesatares. Punimi sjell krahasime të shkurtra edhe me përvojën amerikane për të qartësuar përfundimisht gjendjen e shkollave dhe universiteteve arabe.

Hyrje

Falënderimet i takojnë Allahut, i Cili ia mësoi njeriut të shkruarit dhe atë që nuk e dinte. Falënderimet i takojnë Atij që në Librin Famëlartë thotë:

...Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim." (ez-Zumer: 9)

Përshëndetjet qofshin për zotërinë e njerëzimit, Muhammedin, familjen, shokët dhe pasuesit e tij!

Krahas fushës se interesimeve të mia në tefsir dhe studime kur'anore, si ekspert dhe specialist fetar, Allahu i Madhëruar më pajisi edhe me dashurinë për t'u interesuar për aspektin edukativo-arsimor nëpër shkolla dhe universitete. Gjatë kohës që qëndrova në Azinë Juglindore, në Malajzi, përgatita një punim¹ për shkollat e sistemit të avancuar në Malajzi dhe ndikimin e tyre të madh në nxjerrjen e gjeneratave të suksesshme, punim ky që zgjoi interesim nga disa lexues. E pastaj dallgët e jetës më çuan në një universitet arab, ku për një kohë të gjatë ligjërova disa nga lëndët islame profesionale dhe të tjera. Prej këtyre të fundit, më ra të ligjëroj lëndën e Kulturës Islame (*eth thekafetu-l-islamijeh*) në të dy nivelet e saj. Planprogrami i paraparë përfshinte tema bashkëkohore, si: "*Mesatarja - e vërteta përkitazi me të, nevoja dhe vlera e saj*", "*Ekstremizmi dhe terrorizmi dhe ndikimet negative në jetën e të rinjve muslimanë*" etj. Falë ndihmës së Allahut, kohë më parë përgatita një punim rreth radikalizmit dhe terrorizmit dhe trajtimit adekuat nga perspektiva kur'anore dhe pejgamberike, të cilin e publikoi revista shkencore *el-Hikmeh*². Në punimin në fjalë, trajtova edhe tekstet që kanë të bëjnë me mesataren dhe moderimin.

Gjatë kohës që shërbeva në universitet vërejtja se institucionet arsimore në botën arabe janë jashtëzakonisht të përkushtuara për zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë arsimore, në mënyrë që objektivat edukative të çdo vendi

¹ Studimet postdiplomike, magistraturë dhe doktoratë, në Universitetin Islam Ndërkombëtar të Malajzisë, 1997-2004. www.iiu.edu.my

² Punimi në fjalë është publikuar nga revista *el-Hikmeh*, e cila publikohet në Manchester - Angli dhe në Medine Munevvere - Arabi Saudite, në numrin 37, f. 399-463. Po kështu është përkthyer në shqip nga Sedat Islami dhe është botuar në Takvim 2008.

arab të realizohen dhe të nxirren gjenerata produktive dhe të prosperuara për të qenë të afta për të bashkëvepruar me kohën dhe zhvillimet e saj, për të përfituar nga të mirat e saj dhe për t'u përballuar me sfidat e saja, nën hijen e parimeve dhe vlerave islame.

Për të gjetur një model konkret me perspektivë dhe sukses të dëshmuar hulumtova shumë në institucionet edukativo-arsimore, në mjetet shkencore, kulturën dhe edukatën, me qëllim që të ngrihet edhe shkalla dhe cilësia e mësimit tek nxënësit dhe studentët arabë. Fillimisht u ndala tek institucionet evropiane dhe, thënë nga pozita ime si hulumtues evropian, nuk gjeta apo nuk hasa në diç që do t'ia vlente të mbështetej në të. Gjermania ishte ajo që deri diku më la mbresa dhe vetëm më vonë kuptova se Japonia, pas Luftës së II Botërore, ishte ajo që kishte përfituar nga sistemet arsimore të Gjermanisë dhe Francës.

Hulumtimin e vazhdova edhe atëherë kur kalova nga Lindja e Mesme në Lindjen e Largët, respektivisht në Brunei për të ligjëruar në Universitetin Islam Sulltan Sherif Ali. Hulumtova në institucionet arsimore të disa shteteve të zhvilluara aziatike, si Singapori, Koreja Jugore etj, por në fund e gjeta atë që kërkoja tek sistemi arsimor i Japonisë, i cili ishte në epërsi dhe më i zhvilluar se çdo sistem tjetër arsimor i shteteve përreth.

Me gjithë angazhimin e madh akademik e luta Allahun që të më ndihmonte t'i qasesha studimit të këtij sistemi efektiv arsimor dhe të më shpërblente për mundin që kam dhënë! Konsideroj se kam dhënë një mund modest dhe kam ofruar një model, vlerësimin dhe kritikën për të cilin i pres nga ju.

Shërbyesi i Kur'anit dhe Sunnetit

Dr. Hajredin Hoxha

Brunei Darussalam

“Në vendet komuniste arsimimi është rreptësisht i indoktrinuuar, i dirigjuar dhe i nënshtruar ndaj interesave të ideologjisë sunduese dhe sistemit politik. Në vendet kapitaliste arsimimi në masën më të madhe i përshtatet kërkesave të ekonomisë dhe është në shërbim të sistemit industrial. Në të dy rastet arsimimi është në funksion, në shërbim të sistemit...”

Alija Izetbegović

Islami ndërmjet lindjes dhe perëndimit, f. 56.

-I-

- **SHKOLLAT DHE UNIVERSITETET ARABE NGA KËNDVËSHTRIMI MORAL DHE PROFESIONAL**
- **OBLIGIMET TONA KARSHI STUDENTËVE**
- **INTERESIMI I PUSHTETARËVE PËR ARSIMIN**
- **SEKRETI I SUKSESIT TË SHKOLLAVE DHE UNIVERSITETEVE JAPONEZE**

I.1. NJË VËSHTRIM MBI DUKURITË E SJELLJES DHE MORALIT NË SHKOLLAT DHE UNIVERSITETET ARABE

Ekspertët dhe edukatorët muslimanë tërheqin vërejtjen për një devijim dhe rënie³ të theksuar të moralit, edukatës dhe sukseseve të nxënësve dhe studentëve muslimanë⁴.

Gjatë qëndrimit dhe angazhimit tim si ligjërues në këtë vend arabo-islam (Arabi Saudite) dhe kontaktit tim të drejtpërdrejtë me studentë dhe profesorë të universitetit, kam hasur në disa dukuri dhe sjellje morale dhe ideore të devijuara dhe të lajthitura, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me metodologjinë kur'anore, pejgamberike, tradicionale si dhe janë larg mesatares islame.

Këto dukuri mund t'i përmbledhim në pikat në vijim:

1. Mungesa e seriozitetit në vijimin e mësimit dhe mësimdhënies.
2. Mungesa e organeve kompetente që do të pengonin 'lulëzimin' e këtyre dukurive.
3. Dukuria e rritjes së flokëve.
4. Dukuria e pirjes së duhanit dhe përdorimit të *shisha*-s.
5. Dukuria e prishjes dhe dëmtimit të veturave.
6. Dukuria e vonimit në shkolla dhe ligjërata.
7. Dukuria e përhapjes së internetkafeve dhe qëndrimit deri në orët e vona të natës.
8. Dukuria e ikjes nga shkollat dhe universitetet.
9. Rastet e helmimit në disa shkolla dhe universitet për shkak të mungesës së pastërtisë, qoftë në restorante, në qendra tregtare përreth shkollave dhe universiteteve, apo edhe shitjes së artikujve me afat të skaduar.
10. Injorimi i punës së dorës nga bindja (e gabuar) se punët e tilla janë vetëm për shërbëtorët që vijnë nga jashtë vendi.

³ Revista *el-Emn*, nr. 16, f. 29-30. Janë përmendur shifra të mëdha të shpenzimeve që bëhen për këtë gjë.

⁴ Yalçın, Mikdad, *Subul un-nuhud bit tul-lab hulukijjen ve ilmijjen ila musteva ehdafile ummeti*, f.12-13.

11. Dukuria e mashtrimit dhe tradhtisë në provime dhe humbja e ndjenjës së përgjegjësisë para Allahut të Madhëruar.
12. Dukuria e keqpërdorimit dhe shkatërrimit të inventarit dhe pronës shtetërore në shkolla dhe universitete⁵.
13. Dukuria e favorizimit dhe kalimit për interes të studentëve.
14. Dukuria e konflikteve ndërmjet nxënësve dhe studentëve në ambiente shkollore dhe universitare.
15. Dukuria e pagave të vogla për mësuesit dhe profesorët universitarë, gjë që ka shkaktuar mospërkushtim të madh të tyre në punët profesionale, si dhe hulumtimin për punë të tjera apo orë shtesë, qoftë edhe gjatë natës, vetëm e vetëm për të siguruar të ardhura që do t'iu mjaftonim për vete dhe familjet e tyre.
16. Dukuria e jobesnikërisë ndaj shtetit dhe udhëheqësve nga disa të rinj të indoktrinuar.
17. Dukuria e fjetjes së studentëve gjatë ligjëratave për shkak të qëndrimit deri në orët e vona të natës dhe pamundësisë për t'u zgjuar me kohë.
18. Dukuria e perceptimit të shkollimit universitar si diç që nuk i sjell ndonjë dobi njeriut apo edhe si diç që vetëm duhet pasur një diplomë për të siguruar një vend pune, autoritet apo edhe përmirësimit të pozitës shoqërore.
19. Dukuria e përcjelljes së programeve argëtuese, serialeve dhe filmave çoroditës për moralin e familjes dhe të rinjve, si serialet që bëjnë fjalë për shkurorëzim, tradhti bashkëshortore, konsumim të drogës, dashuri, romantikë etj.
20. Dukuria e përcjelljes së filmave erotikë në kanale satelitore apo edhe nëpërmjet internetit.
21. Dukuria e mungesës së objektivave dhe idealeve të shkollimit, në krye të të cilave sigurisht se qëndron shërbimi ndaj fesë dhe atdheut⁶.

⁵ Yalçın, Mikdad, *Subul un-nuhud bit tul-lab hulukijjen ve ilmijjen ila musteva ehdafile ummeti*, f.13.

⁶ Nahlavi, AbduRahman, *Usulu-t-terbijjetil islamijjeti ve esalijbuha fil bejti vel emdreseti vel muxhtemeë*, f.45-68.

Nëse kjo është gjendja e nxënësve dhe studentëve tanë në shumicën e vendeve arabe dhe islame dhe, nëse studimet universitare reflektojnë dijet e fituara gjatë niveleve shkollore të mëhershme, por jo vetëm dijet dhe zellin, por edhe moralin, sjelljet, mendimet, idetë, organizimin, disiplinën, sinqeritetin, përkushtimin, produktivitetin, bashkëpunimin, solidarizimin, respektin e ndërsjellë etj, atëherë konsideroj se inkorporimi i këtyre elementeve të moderimit që mungojnë në planprogramet dhe metodologjitë tona arsimore është nevojë imediate. Kam bindjen se promovimi i këtyre vlerave të mirëfillta islame dhe kujdesi për mbikëqyrjen e implementimit të tyre është prioriteti i prioriteteve. Patjetër duhet të zbulojmë se çfarë i shtyn studentët tanë që t'iu ikin këtyre vlerave dhe përse bëhen ekstremistë? Doemos duhet të kujdesemi për zhvillimin dhe përgatitjen sa më të mirë profesionale të tyre, gjithnjë nën hijen e këtyre botëkuptimeve të moderimit apo *vesatijjes* islame, siç e quajmë në fjalorin fetar. Këtë ëndërr mund ta bëjmë realitet vetëm nëse ngritjen morale, edukative dhe arsimore të studentëve e marrim shumë seriozisht. Mos harroni, ngritja morale dhe shpirtërore e studentit është mbase ndër shkaqet apo motivet më efektive edhe për ngritjen e tij arsimore, kulturore dhe ideore. Kjo për arsye se kultura islame e pastër është ajo që e shndërron procedurën mësimdhënëse nga *“udhëzimi e sugjerimi në meditim, nga logjika e grumbullimit, transmetimit dhe imitimit në mentalitet shpikës, hulumtues dhe reformues... nga periudha e ndijimit në periudhën e perceptimit (kuptimi), nga parashikimi i parashenjave në kuptimin e rezultateve dhe përfundimeve, nga shenjtërimi i trashëgimisë dhe mburrjes me të në marrjen në pyetje që t'i përgjigjet pyetjeve të së tashmes dhe të parashikojë të ardhmen, nga inekzistenca në të kaluarën dhe mos kthimi në të tanishmen, nga akuzimi i logjikës, bllokimi i saj dhe tentativa për zhvlefësimin e rolit të saj në emër të fesë dhe triumfit të saj në ringjalljen e saj, zhbllokimin dhe perceptimin e rolit të saj, duke e lënë atë të lirë në fushat e hulumtimit (ixhtihadit) dhe të kuptuarit e saktë, si dhe aplikimit të vlerave fetare në aktualitetin njerëzor... nga mentaliteti i dhunës, vrazhdësisë dhe papajtueshmërisë në mentalitet urtësie, meditimi, përsiatje, njohurie dhe fleksibiliteti...”*⁷

⁷ Haseneh, Umer Abiid, *Etth thekafetu el amlubetu hatta nekune fi musteva islamina*, f.60-64.

"Kjo po kështu do të kontribuonte në përdorimin e shkencave dhe njohurive në dobi dhe interes të njerëzve duke shtuar këtu se për studentët, enkas, do të ishte një udhëzim i qartë drejt objektivave madhore islame." ⁸

Ngecja apo ngërçi në mundësinë e realizimit të këtyre botëkuptimeve të moderimit islam në mesin e studentëve tanë konsideroj se është për shkak të mungesës së një eksperience të mirë, të mungesës së shkollave, institucioneve a universiteteve që kanë një sistem arsimor fleksibil dhe efikas, ngase, siç nënvizojnë ekspertët, 'efikasiteti nënkupton përpjekjet për arritjen e gradave më të larta në performancë dhe realizimin e rezultateve më të mira.' ⁹

Performanca në gradë të lartë dhe realizimi i rezultateve të mira në universitetet arabe është diç për të cilin diskutohet shumë. Ekspertët vlerësojnë se 'efikasiteti' vjen në shprehje atëherë kur rezultatet e arritura (outputs) të jenë më të mira dhe më shumë se shpenzimet e bëra (inputs), ndërsa në universitetet arabe ndodh plotësisht e kundërta. Buxheti i tyre është marramendës, por të arriturat janë për të qarë.

Në Kur'anin Famëlartë aludohet në këto 'inputs'-e (të hyrat, obligime materiale, harxhimet) me shprehje dhe emërtime të ndryshme, si: *el-vus'u* (mundësi), *el-kuvvetu* (forcë, fuqi) dhe *err-rribat* (pajisje luftarake). Allahu i Madhëruar thotë:

Ne nuk e obligojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij dhe te Ne është libri (i shënimeve) që i shënon saktësisht (veprat) dhe atyre nuk u bëhet padrejtë." (el-Mu'minune, 62)

E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata. Çkado që shpenzoni për rrugë të All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë." (el-Enfalë, 60)

⁸ Yalçın, Mikdad, *Subul un-nuhud bit tul-lab hulukijjen ve ilmijjen ila musteva ehdafil ummeti*, f.16.

⁹ Robert, Albanese; *Managing: Toward Accountability for Performance*, 3rd ed, Homewood, Illions, 1981, pg:16

Ka dhe shumë ajete të tjera me këto domethënie.

Ndërsa sa iu përket rezultateve ose 'outputs'-eve, Kur'ani i quan 'el-Akibetu' (përfundim) që zakonisht vendoset paralel me besimtarët e devotshëm (el-muttekune), si p.sh. në kaptinën Hud, ajeti 49:

Këto janë disa nga rrëfimet e panjohura (për ty), që po t'i shpallim ty, e që para këtij (Kur'anit) nuk i ke ditur as ti as populli yt. Pra, të jesh i durueshëm se përfundimi (i lavdishëm) është për të devotshmit."

Pra, përfundimi i lavdishëm dhe i suksesshëm do të jetë për ata që i frikësohen ndeshjes me urdhrat e Allahut, ligjet dhe rregullat e Tij. E kur 'efikasiteti' të ketë arritur shkallët më të larta, atëherë Kur'ani këtë apo ata që përshkruhen me të i quan 'el-Muflihune.' Muflihunë janë ata që realizojnë kërkesat.¹⁰

E tash, më thoni se ku janë apo ku duken imazhet e 'muflihune-ve' në shkollat dhe universitete arabe? Ku vërehen aspektet e këtij efikasiteti në rezultatet e tyre? Ku janë rezultatet e pritura në raport me buxhetin e madh të ndarë për reformimin e sistemit edukativ në universitetet arabe? A kemi arritur domethëniet kur'anore të efikasitetit? A i jemi frikësuar ndeshjes eventuale të sistemit tonë edukativ me ligjet e jetës dhe të kozmosit?¹¹ Përpjekjet dhe mundi ynë a janë të mjaftueshme për realizimin e rezultateve të larta? A jemi ndaluar të diskutojmë 'inputs'-et tona në mënyrë që më pas të (kemi të drejtë të) presim rezultate (outputs-e) më të mira?

¹⁰ Kejlani, Maxhid Ursan, *Et terbijjetu vet texhdid ve tenmijjetul failijjeti indel muslimil muasir*, f.11.

¹¹ Gazali, Muhammed, *Sirr-rru te'hiril arab vel muslimine*, f.11-21.

I.2. OBLIGIMI I AVANCIMIT MORAL TË STUDENTËVE DHE PËRKUSHTIMI I LIDERËVE SAUDIANË PËR ÇËSHTJEN NË FJALË

Është synim dhe objektiv pothuaj e çdo institucioni arsimor, e në këtë kontekst, në radhë të parë, e Ministrisë së Edukimit dhe Arsimit, që t'i avancojë moralisht, shkencërisht dhe fetarisht studentët, ndërsa çdo dështim eventual në këtë drejtim, do të tingëllonte si neglizhencë në kryerjen e detyrave.

Me këtë rast do të doja të përmendja disa nisma të qeverisë saudiane për shtjellimin e rëndësisë së temës në fjalë.

- Nisur nga thirrjet e Ministrisë së Edukimit dhe Arsimit dhe vetë Mbretit dhe zëvendësve të tij për ta marrë me shumë seriozitet këtë punë, për të siguruar një avancim kulturor dhe arsimor në vendet e shenjta;
- Bazuar në qëllimet e politikës edukative dhe arsimore të Mbretërisë¹², kemi gjetur se kjo etikë e ulët dhe ky moral i zbehur (tek studentët) nuk i shërbejnë këtyre qëllimeve dhe nuk garantojnë realizimin e tyre tek studentët;
- Nisur nga përgjigja e një të urti, i cili kur qe pyetur për të ardhmen e ndonjë populli pati thënë: *"Më ofroni planprogramet e tyre që t'iu tregoj për të ardhmen e tij!"*;
- Nisur nga fakti se rënia apo degjenerimi moral i studentëve paraqet një barrë materiale të rëndë për shtetin dhe krahas kësaj është shkak për dukuri të tjera negative, qofshin këto fetare, shoqërore apo politike¹³;
- Nisur nga objektivat dhe synimet e përgjithshme islame, kemi gjetur se kjo gjendje apo ky nivel i moralit, sjelljeve dhe mësimit ndjell zi dhe shtron pyetjen se *'ku qëndron problemi: tek studentët, programet arsimore, profesorët apo administrata?'*

¹² *Es sijasetu et-ta'limijeh lil Memleketil Arabijjetis Suudijeh*, el-hedef nr. 27.

¹³ Bekar, Abdul Kerim, *Asruna vel ajshu fi zamanihis sa'b*, f.21-38.

Ekspertët kanë nënvizuar se nëse arrijmë që gjendja të mos eskalojë, atëherë ne kemi bërë një hap të madh¹⁴, ngase 'nëse nuk mund të arrish shumicën, nuk do të thotë ta braktissh tërësisht atë!' – thotë një fjalë e urtë arabe. Kësisoj, interesimi për të përmirësuar nivelin moral dhe etik tek studentët, neve – me lejen e Allahut – do të na garantonte:

- Uljen e nivelit të devijimit dhe krimeve, që kanë filluar të përhapen me të madhe në ambientet studentore, por edhe në shoqëri, si pasojë e neglizhimit të etikës dhe virtyteve islame. Kjo ka bërë që në disa vende arabe, në ambientet universitare të shënohen raste të dhunës së studentëve ndaj njëri-tjetrit, por edhe ndaj profesorëve dhe administratorëve¹⁵. Mu për këtë, ka qenë metodologji e të Dërguarit të Allahut, Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] që së pari të bënte edukimin moral dhe fisnikërimin me vlera e virtyte, e pastaj të kalonte në mësimin e dijeve dhe shkencave.
- Neglizhimi i këtij aspekti në institucionet tona arsimore nuk do të kalonte pa pasoja të tjera, si ajo e mungesës së gatishmërisë për të sakrifikuar për familjen, shoqërinë dhe shtetin, përkundrazi, do t'i bënte studentët robër të epshit, kënaqësive, dëfrimeve dhe ata nuk do të interesoheshin veçse për veten e tyre, andaj intervenimi duhet të bëhet sa më shpjet që të jetë e mundur për t'i shpëtuar nga ky kolaps shpirtëror.
- Mungesa e këtyre qëllimeve fisnike do të bënte që studentët dhe mësuesit ta bënin punën e tyre shkencore dhe akademike me qëllimin e përfitimit të të mirave materiale. Si ilustrim të kësaj do të përmendja rastet kur studenti ankohet pse nuk mori më shumë poenë, ndërsa pse i kalojnë namazet dhe pse mashtron e vjedh në provime nuk e ka dert fare¹⁶.
- Pasojë e kësaj neglizhence është edhe përhapja e disa dukurive dhe sjelljeve jo të mira tek studentët tanë, si ajo e imitimit të të huajve në veshje, doke dhe shprehi, përcjellja e modës perëndimore në dukje

¹⁴ Yalçın, Mikdad, *Subul un-nuhudbit tul-lab hulukijjen ve ilmijjen ila musteva ehdafile ummeti*, f.10-25.

¹⁵ Ulvan, Abdullah nasih, *Esh-shebab el muslim fi muvaxhehetit tehaddijat*, f.35.

¹⁶ Yalçın, Mikdad, *Et-terbijjetul islamijjetu vet tabiatul insanijeh*, f. 20-...

dhe stil të të veshurit, mbajtja e kapelave të stilit perëndimor në kokë apo veshja e pantallonave të stilit të tyre, apo edhe pirja e duhanit¹⁷. Këto imazhe, që bien ndesh me fenë tonë, patjetër se duhet të jenë kambanë alarmi për ne, për të rishikuar metodat tona në edukimin e fëmijëve tanë.

- Po kështu, të gjithë ne duhet t'i bëjmë vetes një kontroll dhe duhet të ripërtërijmë raportet¹⁸ tona me Allahun për të urdhëruar për të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja me fjalë, vepra dhe respektin ndaj organeve dhe rendit. Le të mos harrojmë se Pejgamberi Muhammed [*alejhis salatu ves selam*] që dërguar për përsosjen e moralit, të cilin edukatorët e kanë quajtur si 'Shkenca e obligimeve', për arsye se sqaron dhe hedh dritë mbi obligimet që njeriu ka karshi njeriut, përsosjen e moralit dhe shpjegimet se anashkalimi i këtij aspekti është në kundërshtim me moralin¹⁹.

Ky punim mëton trajtimin e këtij aspekti duke iu referuar vlerave dhe virtyeteve tona islame, e pse jo edhe duke shtuar këtu përvojat e disa vendeve të zhvilluara nga pikëpamja teknologjike dhe trajtimin e institucioneve të tyre arsimore në këtë kontekst për studim dhe krahasime.

Nuk do të duhej ta neglizhojmë faktin se zhvillimi i tyre në fushën teknologjike ka ardhur si rezultat i një sistemi edukativo-arsimor serioz, i cili merret me gjeneratat e ardhshme që nga vegjëlia e tyre. Mungesa e botëkuptimeve të kësaj që po shtjellojmë tek ne dhe prania e fuqishme e tyre në qarqet edukativo-shkencore të Perëndimit bëri që vjelja e sukseseve të ishte pothuajse në përputhje të plotë me strategjinë e vënë më parë. Nuk di pse të mos përfitonin muslimanët nga kjo mënyrë koncize e funksionalizimit të këtyre botëkuptimeve edhe tek ne?!²⁰

¹⁷ Balamesh, Fejsal Seid dhe të tjerë, *Eth-thekafetu el-islamijeh*, niveli 3, f. 193-220.

¹⁸ Kejlani, Maxhid Ursan, *Et terbijjetu vet texhdid ve tenmijjetul failijeti indel muslimil muasir*, 17-66.

¹⁹ Yalçın, Mikdad, *Terbijjetul exhjal ala ahlakijjati ve adabil munakasheti vel muhavereti vel munadharetil ilmijeh*, f. 33-45.

²⁰ Esh-shumejmiri, Ahmed Ibn Abdurrahman, *Kejfe tekun muderr-rrisen naxhihan – 330 nesihatun lil muderr-rrisine vel muderr-rrisat*, f. 20-40.

Pra, nuk kemi zgjidhje tjetër vetëm se t'i bëjmë një rishikim institucioneve tona edukativo-arsimore të të gjitha niveleve, në mënyrë që t'i bashkëngjitemi karvanit të vendeve të zhvilluara dhe të nxjerrim gjenerata që do të bashkëvepronin me këto botëkuptime të mesatares – që mungojnë tek ne – në fushën e shkencës, mendimit, kulturës²¹ dhe industrisë. Them kështu, ngase dijetarët, prej domethëniesve të mesatares, kanë numëruar në Kur'an²² edhe këto: forcë, epërsi, siguri dhe largim nga rreziku, balancë dhe qendër referuese²³, përsosmëri, metodologji e drejtë, pavarësisht se për cilën metodologji bëhet fjalë, fetare, shkencore apo edukative.

E pyetja që lind tash është: *'Sa janë të pranishme këto botëkuptime në institucionet tona edukativo-arsimore?'*

Përgjigjen – me lejen e Allahut – do të mundohemi ta marrim gjatë studimit dhe krahasimit që do t'i bëjmë sistemit edukativo-arsimor të një vendi, që 'ia jep dorën' e tërë bota për industri, teknologji, zell, shpikje dhe punë. Shpresojmë që studimi dhe krahasimi të merren si model për atë se çfarë duhet të bëjmë dhe si duhet të veprojmë, kuptohet pa cenuar referencat tona fetare, Kur'anin dhe Sunnetin. Në fakt, ne marrim të mirat dhe braktisim të tjerat²⁴.

Dëshiroj që lexuesve të nderuar t'ua bëj me dije se gjatë krahasimit tonë nuk do të ndalemi të sqarojmë gjendjen e shkollave dhe universiteteve arabe, ngase një gjë të tillë, edhe pse kalimthi, e bëmë më parë, porse do të bëjmë krahasime ndërmjet sistemit japonez dhe atij amerikan, në mënyrë që, nëpërmjet tyre, të sqarohet niveli i sistemit edukativo-arsimor arab, ngase siç thuhet *'gjërat dallohen me opozitat e tyre.'* Sociologët dhe edukatorët thonë: *'Rrathët e sjelljes njerëzore fillojnë me shpirtrat, pra me rrethin e idesë, pastaj atë të vullnetit, pastaj shfaqet rrethi i tretë i cili është rrethi i*

²¹ Mustafa, Muslim, *Eth-thekafetu el islamijeh – ta'rifuha, mesadiruha, mexhalatuhu, tehaddijatuha*, f. 261-277.

²² Kardavi, Jusuf, *el-Hasais el amme lil Islam*, f.127-157; Ahmed, Semir Abdul Hamid el-Kutb, *Dhahiretu unfi-sh-shebab fil muxhtemeil arabijj: esbabuha ve subulu ilaxhiha min mendhurin terbevijin – dirasetun mes'hijjetun*, Konferenca Ndërkombëtare 'Esh-Shebab el-xhamijj vet tesaddi lil irhab, Univeristeteti Tajjiba në Medine Munevvere, 2004.

²³ Hindi, Salih dhe të tjerë, *Eth-thekafetul islamijeh*, f.97-107.

²⁴ Badehdah, Ali Umer dhe të tjerë, *Eth-thekafetu el-islamijeh*, f.89-106.

ushtrimit dhe realizimit konkret. Nëse rrethi i parë ka ndonjë të metë, atëherë ajo e metë do të reflektohet edhe tek dy rrethët e tjerë, respektivisht do të dyfishojë papunësinë, paralizimin (mos punën), dobësinë dhe prapambeturinë...²⁵
Ndoshta në këtë botëkuptim ka aluduar Kur'ani, në ajetin 11 të kaptinës err-Rra'd:

... All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre. ..."

Popujt e zhvilluar e kanë traditë që nëse vërejnë se diç nuk po funksionon dhe se nuk po shënojnë rezultate, atëherë dijetarët dhe ekspertët fillojnë të kontrollojnë vlerat shoqërore dhe sistemet edukative për të dhënë zgjidhjet e kënaqshme për daljen nga kriza²⁶. Këtë e gjë e bëri Britania kur pa epërsinë gjermane në Luftën e Dytë Botërore, apo SHBA-të kur panë ish-Bashkimin Sovjetik që ua parapriu në zbritjet në hapësirën kozmike, apo edhe kur panë Japoninë dhe zhvillimin e saj të hatashëm teknologjik²⁷.

²⁵ Kejlani, Maxhid Urgan, *Et terbijjetu vet texhdid ve tenmijjetul failijjeti indel muslimil muasir*, f. 4.

²⁶ Ulvan, Abdullah nasih, *Esh-shebab el muslim fi muvaxhehetit tehaddijat*, f. 26-32.

²⁷ James J. Shileds; *Japanese Schooling: Patterns of Socialization, Equality and Political Control*, 3rd ed. The Pennsylvania State University Press, 1993, pg; 10- 15

I.3. SEKRETI I EPËRSISË SË SHKOLLAVE JAPONEZE DHE SHKAQET QË E NDIHMUAN ATË

Shumë analistë, vëzhgues dhe ekspertë, me origjinë arabe dhe të tjerë, kanë pyetur me kureshtje se ku qëndron shkak i kësaj epërsie dhe këtij suksesi të shkollave, universiteteve dhe institucioneve arsimore japoneze në krahasim me institucionet e tyre? Përgjigja që morën ishte vetëm në një fjalë: 'Udhëheqësia'²⁸ Kur qe pyetur perandori japonez për shkaqet e përparimit të vendit të tij për një kohë të shkurtër, pati thënë: *'Filluam atje ku të tjerët mbaruan dhe mësuam prej gabimeve të tyre. Mësuesit i dhamë imunitet diplomatik dhe pagë ministri.'* Ndërsa kur qe pyetur një ish-ministër i arsimit për këtë gjë pati nënvizuar: *'Sekreti ynë qëndron tek edukimi ynë moral...'*²⁹

Ambasadori amerikan Edwin O. Reischauer e ndërlidh këtë sukses me dy gjëra:

- 1) Hakmarrjen ndaj historisë, në kuptimin e asaj se i është kundërvënë dështimeve dhe disfatave të historisë me këtë ngritje dhe zhvillim të madh³⁰, dhe
- 2) Ndërtimin e njeriut, në kuptimin e specializimit dhe aftësimit të tij nga sistemi edukativo-arsimor. Madje vetë ambasadori shton se suksesi i zhvillimit japonez bazohet në burimin njerëzor dhe zhvillimin e tij, gjë që i ka bërë japonezët të jenë ndër të parët sa i përket përqindjes së dijetarëve dhe inxhinierëve (60.000 në 1 milion) ndërsa në qendrat e hulumtimeve dhe zhvillimit janë të angazhuar 800.000 veta, aq sa nuk kanë së bashku Britania, Franca dhe Gjermania³¹.

Zanafilla e zhvillimit japonez fillon në vitin 1868, në kohën e Perandorit Mutsuhito, sundimi i të cilit filloi më 3.11.1852. Ai ishte i ri, transparent dhe perandoria e tij quhej *'meiji'* apo *'sundimi i ndriçuar'*. Pikërisht në

²⁸ <http://www.alshref.com/vb/t115785.html>

²⁹ Edward R. Beauchamp, *Et-ta'lim el jabaniij ve-t-ta'lim el-emrikijj – dirasetun mukarenatun* (përkthyer në arabisht nga Prof. Muhammed Taha Alijj), f.32-33.

³⁰ <http://www.mohyessin.com/forum/showthread.php?t=6667>

³¹ Ibid.

kohën e tij u vunë themelet e zhvillimit modern të Japonisë³². Paragrafi më i rëndësishëm i Kushtetutës së kësaj perandorie ishte paragrafi i pestë, i cili përkitazi me arsimimin thoshte: *'Do të punohet në drejtim të mbledhjes së informacioneve nga e tërë bota dhe rrjedhimisht perandoria do të vendoset mbi themele të forta.'*³³ Koha dëshmoi për seriozitetin e kësaj nisme, pasi që Japonia i përvetësoi këto botëkuptime në një sistem të përbërë arsimor dhe ja sot metodologjitë dhe planprogramet e saj edukativo-arsimore jo vetëm që janë të rangut botëror, por janë edhe model përvetësimi i të cilave synohet nga shumë shtete të botës.

Paga e mësuesit japonez

Besoj se nuk ka diç të keqe nëse përmendim disa të dhëna interesante për pagën e mësuesve dhe profesorëve japonezë.

Nr.	Pozita	Niveli i pagës mujore	Përfitimet shtesë
1.	Arsimtar në shkollë të mesme	Paga fillestare ose bazë: 6250 \$	Gjatë vitit akademik përfiton tri (3) herë bonuse në vlerë prej pesëfishin e pagës bazë, që do të thotë se nëse ka një pagë bazë prej 6250\$, atëherë shuma e bonuseve që fiton gjatë vitit është 31250\$. Kjo i bie që, krahas pagës bazë, të marrë çdo muaj edhe nga 2604\$. Bonuset rriten në bazë të përvojës dhe shërbimeve, ndërkohë që marrin shtesa edhe për familje dhe gjëra të tjera. Po kështu, mësuesit japonezë marrin

³² See: Peak, Lois; *Learning to go to School in Japan*, Berkely & Los Angeles, University of California Press, 1991

³³ *'Urtësia është gjë e humbur e besimtarit, të cilën ai duhet ta marrë kudo që ta gjejë,'* - është ky hadith që konsideroj se japonezët e kanë përfillur nga këndvështrimi shpirtëror i tyre. Ani pse i dobët, siç ka tërhequr vërejtjen Shejh Albani, megjithëkëtë, muslimanët e kanë anashkaluar gabimisht porosinë e tij.

			edhe të holla në formë të beneficioneve afatshkurtra në raste të veçanta, si sëmundja, lindja, dhe afatgjata, si pleqëria dhe pensionimi, apo edhe të ardhura për familjen e të vdekurit, të tëra këto përveç sigurimit të mbështetur nga qeveria... ³⁴
--	--	--	--

Përvoja japoneze ka zgjuar kureshtjen e Amerikës, Evropës, Ruisë, të cilët kanë angazhuar kokat e tyre për të studiuar rezultatet e jashtëzakonshme të këtij shteti lindor, i cili po i sfidon gjithnjë e më tepër në fushën e teknologjisë dhe përparimit industrial.

Edhe arabët muslimanë kanë shfaqur interesim për përvojën japoneze, gjë që mendoj se është motivuar kryesisht nga shkaqet në vijim:

Japonezët janë lindorë, sikurse arabët, dhe edhe ata e filluan rrugëtimin drejt zhvillimit nga zeroja, megjithëse muslimanët kanë dallime sa i përket të kaluarës së tyre historike. Ata nuk kanë qenë në zero, përkundrazi, kanë qenë pionierë të dijes dhe shkencave, kështu që kthimi i rrotës së zhvillimit mbase është më lehtë për ta se sa për të tjerët³⁵.

Japonezët e shënuan këtë progres falë ruajtjes me fanatizëm të trashëgimisë, zakoneve dhe institucioneve të tyre popullore, fetare dhe autoktone, gjë që, e them me keqardhje, nuk është evidente tek arabët, për të mos thënë se ata, për hatër të këtij progresi, janë të gatshëm të sakrifikojnë dhe trashëgiminë e tyre islame.

Siç kanë vërejtur ekspertët, dhënia pas punës tek japonezët është si rezultat i diturisë që ata marrin qysh në fëmijëri. Ky edukim është aq i theksuar sa që japonezët kanë bindjen se ndalja nga puna do të thotë mosekzistim për shtetin e tyre.

³⁴ <http://www.garndabi.com/vb/showthread.php?t=4226>

³⁵ Gazali, Muhammed, *Sirr-rru te'hiril arab vel muslimine*, f. 7-91; El-Mursafi, Sa'd, *Eth-thekafetul islamijeh ve etheruha fi tekvinish shahsijetil islamijeh*, f. 151-163.

Ummeti do të duhej të hartonte strategji kulturore, me vizion dhe objektiva të qarta, për të cilën do të duhej të kishte një pajtim unanim ndërmjet intelektualëve dhe organeve qeverisëse³⁶. Akuzat se *'lindorët nga vetë natyra janë dembelë dhe se e urrejnë ligjin dhe punën', 'arabi nuk e duron dot bashkimin dhe unitetin', 'kultura arabe është kulturë e fjalëve dhe retorikës', 'muslimani duron dhunën duke pritur shpëtimtarin nga qielli', duken të jenë të vërteta dhe fajin për këtë sigurisht nuk e kanë muslimanët, por institucionet edukativo-arsimore që e edukojnë njeriun që të heshtë pa pasur mundësi të diskutojë, që të përfillë dhe zbatojë urdhrat pa shikuar apo krahasuar dëmet dhe dobitë e tyre etj. Kjo, e tëra, hyn në kapitullin e të ashtuquajturës *'Dobësia nga vizioni për vetveten!'* Këta, siç kanë nënvizuar ekspertët, e shohin veten vetëm ashtu siç i shohin të tjerët ata (pasqyra shoqërore). Në këtë rast, imazhet tona do të ishin sikurse reflektimet e pasqyrave karnavale, herë me imazhe të zvogëluara e herë të zmadhuara, herë me imazhe të thyera e me sy të hapur e herë me sy të vegjël.³⁷*

Pra, problemi kryesor i arabëve bashkëkohorë është se ata nuk kanë dhe nuk posedojnë kriteret dhe standardet e një personaliteti të pavarur. Ata disi kanë një mungesë besimi në vetvete dhe në vlerat që posedojnë. Në kohën tonë, ata janë viktimat të vlerësimit të të tjerëve për ta, siç potencuam edhe pak më lart³⁸.

³⁶ <http://www.mohyssin.com/forum/showthread.php?t=6667>

³⁷ Kejlani, Maxhid Ursan, *Et terbijjetu vet texhdid ve tenmijjetul failijjeti indel muslimil muasir*, f.19-22; Yalçın, Mikdad, *Devru et terbijjeti el ahlakijjeti el islamijjeti fi binail ferdi vel muxhtemei vel hadaretil insanijjeti*.

³⁸ Kardavi, Jusuf, *Thekafetud daijeh*, f. 119-120.

I.4. SHKAQET QË NDIHMUAN AVANCIMIN JAPONEZ

Analistët dhe ekspertët kanë nënvizuar se në suksesin e përvojës japoneze kanë ndikuar një sërë shkaqesh historike dhe gjeografike. Sidomos këto të fundit e bëjnë Japoninë tejet të veçantë: 1/5 e sipërfaqes së saj është jopjellore dhe nuk mund të përdoret për asgjë, sikurse që pjesa tjetër e tokës së pëlleshme e ka të vështirë të mbulojë nevojat dhe kërkesat e vendit. Këto kushte dhe rrethana bënë që japonezët, shekull pas shekulli, të punonin shumë derisa përfituan *'shprehitë dhe etikën e punës'*, të cilat, sipas disa analistëve, janë *'shprehitë dhe etika më e thellë dhe më origjinale e punës në nivel botëror.'*

Të identifikuarit e Japonisë si një vend që përballet shpesh me erëra dhe tërmete të fuqishme ka bërë që populli i saj të fitojë një tipar tjetër, e ai është "mundësia e përshtatjes dhe ambientimit të shpejtë." Elementi 'kolektiv' dhe puna ekipore³⁹ janë imazh dhe tipar karakteristik i identitetit të tyre kombëtar.

Japonia shtrihet në lindje të kontinentit aziatik dhe përbëhet afërisht prej 4.000 ishujve, të cilët shtrihen në formë arkipelagu 3.000 kilometra ndërmjet veriut dhe jugut, katër prej të cilëve janë më kryesorët: Honsho, Shikoku, Kyushu dhe Hokkaid. Kryeqytet i Japonisë është Tokio.

Japonia numëron diku 127 milionë banorë dhe radhitet si vendi i shtatë në botë për nga popullsia. Shumica absolute e popullsisë janë japonezë (99.4%) por ka edhe të tjerë, si koreanë 0.5% dhe nacionalite të tjera 0.1%. Shumica e japonezëve (79%) jetojnë në qytete, por ka edhe të atillë (21%) që jetojnë në fshatra ose në periferi të qyteteve. 35% e popullsisë punojnë në industri, ndërsa 27% punojnë në fusha. Janë afër 700.000 peshkatarë, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë merret me tregti dhe profesione të tjera të lira. Industria, bujqësia por edhe vendbanimet janë kryesisht në fusha afër bregdeteve, për shkak të popullsisë së dendur në qytetet bregdetare, gjë që ka shkaktuar edhe ngritjen astronomike të çmimeve të tokave.

Shkaqet e ngritjes dhe zhvillimit në Japoni do të mund t'i përmbledhim në

³⁹ Ibid.

pikat vijuese:

- Personaliteti japonez, i cili është i shquar për disiplinë, për shfrytëzim maksimal të kohës, për respektim të rendit, për mirësjellje, për sinqeritet dhe korrektësi në shitblerje etj. Këto vlera janë patjetër rezultat i përkushtimit ndaj programeve edukative qysh nga fëmijëria në shtëpi, shkollë dhe shoqëri. Po kështu, ligji japonez është shumë i ashpër. Ai nuk fal askënd, pavarësisht pozitës apo prestigjit që ka personi që kryen kundërvajtje. Kur zbulohen afëra korruptive apo sjellje devijante, atëherë shteti merret me to duke studiuar shkaqet e tyre dhe ndëshkimet jepen sipas rastit, në mënyrë që ato të mos përsëriten më⁴⁰.
- Respektimi dhe përfillja e fjalëve të filozofëve dhe të urtëve përkitazi me vlerat morale. Vlerat shoqërore japoneze e detyrojnë njeriun të kërkojë falje, për çka ata, në të shumtën e rasteve, i pranojnë fajet dhe kërkojnë ndjesë. Në vitin 1989 japonezët shënuan sukses kur rishikuan programet edukative dhe bënë pastrimin e tyre nga vlerat individuale të importuara, duke caktuar që programi të rishikohet çdo dhjetë vjet⁴¹. Lënda e sjelljes dhe moralit është pjesë e të gjitha lëndëve shkollë, e cila, si ide, ka lindur nga konfuçioizmi. Filozofia e kësaj lëvizjeje (që ata e marrin për fe), përveç që thërret për shkencë, dije dhe njohuri, thërret po kështu edhe për miqësi ndërmjet prijësit dhe popullit, zotërisë dhe shërbëtorit, prindit dhe fëmijës, të madhit dhe të voglit, e kështu me radhë⁴².

Disa ekspertë konsiderojnë se ky përparim është arritur në saje të dy gjërave kryesore:

- 1) Ekzistimit të një qeverie të fortë, dhe
- 2) Ekzistimit të një sistemi edukativ të suksesshëm.

Pra, zhvillimi i Japonisë i detyrohet vetë japonezëve, të cilët të motivuar

⁴⁰ Krahasoje këtë me gjendjen e universiteteve në tokat arabe për të parë mungesën e këtyre botëkuptimeve në këto të fundit.

⁴¹ Krahasoje këtë me universitetet arabe që të vëresh dallimet.

⁴² Krahasoje zbatimin nga ana e muslimanëve në përgjithësi dhe studentëve në veçanti të sunnetit të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] dhe zbatimin nga ana e japonezëve të mësimëve të konfuçionizmit.

nga vullneti fanatik për progres dhe përparim japin çdo gjë nga vetja e tyre. Ata njihen për zell dhe elan, për angazhim që nuk di fare për lodhjen. Kur të kemi shkoqitur detaje nga jeta brenda shkollës japoneze, atëherë ne do ta gjejmë veten para një dukurie apo fenomeni edukativo-arsimor frytdhënës të çuditshëm. Komentimi i kësaj dukurie nuk ndalet vetëm në dëshirën për ngritje shoqërore, pro edhe për dëshirën e singertë për arsimim dhe ngritje. Populli japonez mbetet shkak shumë i rëndësishëm i suksesit të kësaj përvoje. Ata krahas dashurisë për vendin dhe shtetin e tyre, shprehin dashuri edhe për leximin, artin dhe shkencën.

A nuk ka ardhur koha që të kthjellemi prej asaj kotësie që është stërzgjatur?!⁴³

Përse të mos përfitojnë muslimanët nga kjo përvojë e gjallë dhe realiste?!⁴⁴

⁴³ [www://thawra.alwahda.gov.sy](http://www.thawra.alwahda.gov.sy)

⁴⁴ Gazali, Muhammed, *Dusturu el vihdeti-th-thekafijjeti*, b.4, f. 167-177.

-II-

**OBJEKTIVAT EDUKATIVE NË ARSIMIN JAPONEZ,
VEÇORITË E ARSIMIT JAPONEZ DHE NJOFTIM ME
SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME NË JAPONI**

II.1. OBJEKTIVAT EDUKATIVE NË ARSIMIN JAPONEZ DHE QËNDRIMI I LIGJIT KARSHI TYRE

Ekspertët japonezë kanë vënë një sërë objektivash arsimore, të cilat nxënësi japonez patjetër se duhet t'i realizojë gjatë periudhës së mësim, prej të cilave do të veçonim:

- 1) Zhvillimi i personalitetit individual, për shkak të ngritjes së anëtarëve të tjerë dhe zhvillimit të tyre
- 2) Kultivimi i dashurisë për të vërtetën dhe drejtësinë
- 3) Vlerësimi i tjetrit
- 4) Respektimi i punës dhe ndërgjegjësimi karshi përgjegjësive
- 5) Mbështetja në vetvete dhe pavarësimi personal
- 6) Kultivimi i kulturës nëpërmjet respektit reciprok dhe bashkëpunimit, për të krijuar, si rezultat, një shoqëri të sigurt dhe të qetë⁴⁵.

Për realizimin e këtyre objektivave, Ministria e Arsimit dhe Edukimit është koordinuar me organet gjegjëse për miratimin e një ligji që do t'i detyronte kujdestarët e fëmijëve t'i dërgonin këta të fundit për nëntë vjet me radhë në shkollimin bazik. Ligji ka garantuar se fetë do të respektohen dhe se pozita e saj në jetën shqopore do të ruhet, por jo në formë të ndonjë feje të caktuar.

⁴⁵http://www.ibe.unesco.org/fileadmin/user_upload/archive/Countries/WDE/2006/ASIAandthePACIFIC/Japan/Japan.pdf;
<http://home.hiroshima-u.ac.jp/cice/JEF2report1e.pdf>;
http://www.studyinjapan.org.my/04_study/04_study2_qna.html

II.2. VEÇORITË E SISTEMIT ARSIMOR TË JAPONISË

Arabia Saudite është interesuar kaheerë për sistemin arsimor të Japonisë. Ambasada saudite në Japoni para ca kohësh, në faqen zyrtare në internet, ka publikuar një studim për veçoritë më të spikatura të këtij sistemi arsimor, të cilat janë:

1) Centralizimi dhe decentralizimi në arsim

Japonia, përgjithësisht, ka një sistem arsimor të centralizuar, përparësitë e të cilit janë ofrimi i kushteve të njëjta ose barazia në nivel shteti për të gjitha shtresat. Kështu, fëmijët pajisen me njohuri të njëjta, pavarësisht se në cilën pjesë të shtetit janë dhe pavarësisht gjendjes ekonomike që zona përkatëse gëzon. Ministria e Arsimit merr përsipër hartimin e planprogrameve deri edhe në detajet më të thjeshta, duke siguruar kështu një mësimdhënie të unifikuar. Shkollat mund të dallohen ndërmjet vetë vetëm nga niveli i sukseseve të arritura. Ministria është përgjegjëse edhe për hartimin e strategjive arsimore në nivel shteti, sikurse që menaxhon edhe një sërë institucionesh arsimore, në mesin e të cilave edhe universitete.

Japonia u shndërrua nga një vend feudal në një gjigant industrial dhe ekonomik, kështu siç është sot, në saje të shkollave, të cilat luajtën të njëjtin rol edhe pas Luftës së Dytë Botërore, prej së cilës ajo kishte dalë e kapitulluar dhe tërësisht e dërrmuar⁴⁶.

2) Puna kolektive, sistemi dhe përgjegjësia

⁴⁶ http://www.saudiembassy.or.jp/Ar/Education/Ed_n_jp_Car.htm

Sistemi arsimor japonez fokusohet në ngjalljen e ndjenjave për punë kolektive⁴⁷, për përgjegjësi të nxënësve ndaj shoqërisë, duke startuar me shkollën, respektivisht përkujdesjen për objektet dhe inventarin e saj.

Përkujdesja higjienike e shkollave japoneze është gjë e dëshmuar. Me të hyrë në një objekt shkollor do të hasësh të mbathura të lehta sportive të vendosura në rafte e mbishkrime me emrat e secilit prej nxënësve. Është obligim që të zbathen këpucët e rëndomta dhe të vishen ato të pastra, ngase kështu ruhet pastërtia brenda objektit. Kjo traditë përfillet pothuajse në të gjitha shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme⁴⁸.

Çdo ditë, në përfundim të orarit mësimor, nxënësit i pastrojnë sallat e mësimi, e madje pastrojnë edhe korridoret dhe banjat⁴⁹ ndërsa nuk shkojnë pa mbledhur edhe letrat në oborrin e shkollës nëse janë grumbulluar. Jo rrallë ndodhë që aksionet për pastrim, qoftë brenda shkollës apo edhe jashtë saj, si parqe, plazhe etj, të organizohen nga vetë mësuesit. Kjo nënkupton se në shkollat japoneze nuk ka pastrues. Pastrimi është barrë e profesorëve dhe nxënësve të tyre⁵⁰. Nuk ka madje as portier, ndërsa nxënësit përkujdesen edhe për kafshët dhe shpezët që mbahen në shkollë.

Nxënësit nuk edukohen vetëm në frymën e punës kolektive, por atyre iu mësohet edhe të jenë prijatarë, e cila, si vlerë, reflekton në traditën e caktimit të njërit prej nxënësve për mbikëqyrjen e klasës gjatë mungesës së mësuesit, për organizimin e saj dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësve. Në fund të orarit mësimor, nxënësit tubohen dhe e pyesin njëri-tjetrin nëse i kanë përfunduar detyrat në mënyrën më të mirë të mundshme, apo a janë ballafaquar me ndonjë problem.

Padyshim, kjo metodologji në arsim mëton krijimin e klimës së punës kolektive, të bartjes së përgjegjësisë, të përfilljes së urdhrave dhe marrjes

⁴⁷ Si dëshmi për studimin, hulumtuesi e ka shoqëruar edhe me foto të marra nga Ambasada Saudiane në Japoni.

⁴⁸ Shikoje shtojcën me fotografi.

⁴⁹ Shikoje shtojcën me fotografi.

⁵⁰ Shikoje shtojcën me fotografi.

së udhëheqësisë, sikurse që nënkupton sfidimin e sjelljeve dhe veprimeve negative...⁵¹

3) Zelli dhe mundi janë më të rëndësishme se dhuntia dhe zgjuarsia

Përkundër shumë shteteve, Japonia dallohet për maksimumin e saj 'Zelli dhe angazhimi janë më të rëndësishme se dhuntia dhe zgjuarsia natyrore e fëmijës', gjë e theksuar edhe në fjalorin e tyre, respektivisht në fjalët që përdoren shpesh e që dëshmojnë këtë, si:

<i>Ganbarimasu</i>	Do ta jap maksimumin tim
<i>Isshookenmei yarimasu</i>	Do të punoj me tërë përkushtimin

Nxënësit japonezë besojnë në këshillat e prindërve, mësuesve dhe edukatorëve të tyre se suksesi, krahas zgjuarsisë dhe inteligjencës, arrihet edhe falë zellit dhe përkushtimit, duke hapur kështu rrugën për të gjithë ata që t'i qasen çfarëdo fushe që duan ngase *'që të gjithë janë krijuar të njëjtë dhe secili ka mundësi të përvetësojë dhe studiojë atë që ka dëshirë duke arritur rezultate dhe suksese falë këtij angazhimi.'*

Mu për këtë, nxënësi apo studenti, përderisa ka këtë vendosmëri për të dhënë mundin dhe angazhimin maksimal, mund të mësojë çfarëdo lënde, edhe nëse nuk ka prirje për të, ngase *'suksesi dhe epërsia nuk determinohen me dallime në shkallë inteligjence por me dallime në shkallë angazhimi dhe pune.'*

Nxënësit japonezë llogariten ndër më aktivët në të gjithë botën, për shkak të bindjeve se avancimi në shkolla të mesme dhe më pas në fakultete me famë nuk mund të bëhet ndryshe veçse me përkushtim dhe sukses të lartë, sikurse që nuk mund të bëhet ndryshe as më vonë atëherë kur do të kërkojnë vende pune.

Kjo flet për vendosmërinë dhe zellin e madh të nxënësve dhe studentëve japonezë. Madje, ata kanë edhe një maksimum:

<i>yontoo goraku</i>	Katër orë sukses, pesë orë dështim
----------------------	------------------------------------

⁵¹ http://www.saudiembassy.or.jp/Ar/Education/Ed_n_jp_Car.htm

Kjo nënkupton se nëse studenti bën katër orë gjumë ndërsa të tjerat ia kushton mësimit, mund të arrijë suksese, ndryshe, po fjeti me shumë, në këtë rast pesë orë, atëherë dështon.

Është e njohur tashmë se universitetet atje kanë edhe role të ndara. P.sh. Universiteti 'Tokyo' bën përgatitjen e gjeneratave për pozita të larta burokratike, Universiteti 'Waseda' nxjerr politikanë dhe gazetarë, ndërsa Universiteti 'Keiyoo' nxjerr biznesmenë të suksesshëm etj.⁵²

4) Sasia e njohurive dhe barra e ngarkesës studimore

Viti akademik japonez dallon pothuajse nga tradita e të gjitha vendeve të tjera të botës. Studimet fillojnë më 1 prill ndërsa mbarojnë më 31 mars të vitit vijues. Ditët dhe orë mësimore janë më gjatat, në krahasim me vendet e tjera. Zakonisht mësimet fillojnë nga ora 8 në mëngjes e deri në orën 16 pasdite. Ky orar nuk vlen për mësuesit. Ata qëndrojnë edhe më gjatë. Pushimet janë edhe më të rralla. Në pranverë kanë dhjetë ditë, për vitin e ri kanë po kaq, ndërsa për pushimet verore kanë 40-45 ditë.

Edhe pse në ditë pushimi, megjithatë nxënësit dhe studentët janë prapë të angazhuar, qoftë nëpërmjet kurseve të caktuara për t'u ndjekur paraprakisht, apo edhe nëpërmjet detyrave jo të pakta që marrin për t'i kryer në shtëpi. Po kështu janë të angazhuar edhe në aktivitete sportive, si p.sh. not, të planifikuar sipas orarit të caktuar nga shkolla.

Si rezultat i këtij angazhimi dhe këtyre ditëve të shumta studimi, nxënësit japonezë kanë epërsi ndaj nxënësve të vendeve të tjera. Thuhet se një nxënës japonez 12 vjeçar ka nivelin e vetëdijes dhe njohurive të një 15 vjeçari në vendet e tjera të zhvilluara. Kjo flet për cilësinë e mësimit japonez. Në të kaluarën, para Luftës së Dytë Botërore, thuhej se sistemi arsimor në Japoni mbështetej në memorien (nxënien përmendsh), por tani flitet për fleksibilitet, zgjuarsis dhe avancim bukur të madh...⁵³

5) Entuziazmi i nxënësve dhe prindërve të tyre për mësim dhe pozita e lartë e mësuesit

⁵² http://www.saudiembassy.or.jp/Ar/Education/Ed_n_jp_Car.htm

⁵³ http://www.saudiembassy.or.jp/Ar/Education/Ed_n_jp_Car.htm

Kinezët, qysh moti, i kanë kushtuar rëndësi arsimit. Në të kaluarën, forca e një lideri matej me dijen dhe njohuritë që kishte. Po kështu, edhe përzgjedhja për poste të rëndësishme bëhej pikërisht në saje të aftësive dhe dijes. Këto bindje i referohen apo janë rezultat i konfuçionizmit, që megjithëqë është vetëm një filozofi, ata e marrin edhe për fe. Nga kjo lëvizje apo fe janë ndikuar edhe koreanët dhe japonezët. Kjo filozofi ndërtohet mbi një sistem shoqëror, baza e të cilit është etika dhe morali, ndërsa udhëhiqet nga liderë të shquar për dije, njohuri dhe moral të mirë. Besnikëria ndaj këtyre liderëve, pavarësisht se në ç'shcallë janë, është mbështetje e këtij sistemi. Kjo filozofi vërtetohet apo i del në krahë sistemit shekullar të gjykimit të natyrës. Pra, bazohet vetëm në dije dhe eksperimente, gjë që kërkon mund dhe angazhim të madh. Këtu mbase qëndron edhe entuziazmi i madh i japonezëve për dije dhe etikë.

Për ta kuptuar edhe më mirë rëndësinë e arsimit, do të përmendim diç për rolin e mësuesit. Mësuesit kanë një pozitë shumë të lartë në shoqëri. Ata fitojnë të ardhura aq sa ua mundësojnë një jetë të qetë dhe të lumtur. Gjinitë nuk kanë dallim, por jo çdokush mund të bëhet mësues. Megjithëse shumica janë të diplomuar, prapë nuk mund ta ushtrojnë këtë detyrë pa iu nënshtruar paraprakisht disa provimeve shumë të rënda. Krahas angazhimeve në detyra dhe në studime për ngritjen eventuale akademike, ata interesohen edhe për çështjet private të nxënësve. I vizitojnë madje edhe në shtëpitë e tyre, për t'ua përkujtuar obligimet, për t'i ndihmuar eventualisht dhe për t'i parë nga afër raportet familjare. Ata kanë jetësuar në praktikë thënien e famshme arabe *'Ngrihu për mësuesin dhe nderoje atë, ngase mësuesi gati sa nuk është peygamber...'*⁵⁴

Nga kjo që pamë tek sistemi arsimor japonez mund të mësojmë për domethëniet e moderimit dhe mesatares që mungojnë në shkollat dhe universitetet tona, sidomos botëkuptimet e forcës, centralizimit, përsosmërisë, sigurisë etj.

Krahas kësaj që përmendëm, ekspertët dhe analistët kanë përmendur se sistemi arsimor japonez shquhet edhe për atë se:

⁵⁴ http://www.saudiembassy.or.jp/Ar/Education/Ed_n_jp_Car.htm

- Bazat dhe elementët përbërës të tij i merr nga natyra e shoqërisë dhe harmonia e saj.
- Ngritjen dhe zhvillimin modern e bën duke u mbështetur në rrënjët, institucionet, doket dhe zakonet në vend.
- Arsimi konsiderohet shërbim popullor dhe obligim nacional, duke tejkuluar suazat e individit apo grupit, ndërsa qysh nga periudhat e hershme fokusohet në mësimet për unifikim, ngase nuk lejon pluralizëm të metodologjive dhe filozofirave edukative.
- Me gjithë kritikën e ashpra të Perëndimit dhe presionin e vazhdueshëm, Japonia i ka ruajtur me fanatizëm vlerat e veta në ideologji dhe sjellje duke mos u ndikuar aspak nga tendencat liberale dhe psikologjike të Perëndimit.
- Universitetet nuk janë burimi i fuqisë së sistemit arsimor në Japoni, përkundrazi, janë institutet e mesme teknologjike, të cilat janë si të thuash boshti kurrizor i këtij sistemi. Ushtrimet praktike dhe trajnimet janë obligimet më të theksuara të japonezëve, të cilët qysh nga fëmijëria e derisa të kenë fituar ndonjë pozitë të qëndrueshme, merren vazhdimisht me ushtrime dhe trajnime⁵⁵.
- Japonia ka mundësi që t'ua garantojë të gjithëve të drejtën e shkollimit, por këtë e bën vetëm për ata që dëshmojnë, në mënyrë që të nxjerrë një elitë udhëheqëse që do të jetë e aftë për të sfiduar problemet dhe sfidat e kohës.
- Japonezët nuk janë ndikuar shumë nga gjuhët e huaja. Siç është e ditur, një popull nuk do të mund të avancojë shkencërisht nëse paraprakisht nuk i kushton rëndësi gjuhës së vet, ndërsa bota nuk e dëgjon shumë popullin që nuk flet në gjuhën e vet. Hapja e Japonisë ndaj kulturave dhe civilizimeve të tjera ka qenë shumë e disiplinuar; ajo ka përvetësuar nga kulturat e tjera, por kurrë në kurriz të kulturës dhe civilizimit të vet.
- Profesionit i mësuesit konsiderohet fitimprurës, mu për këtë, kjo mundësi nuk i jepet çdokujt. Në fakt, vetëm një nga pesë kandidatët të mundshëm mund ta fitojë këtë profesion dhe të gëzojë privilegjet e tij. Kjo ka ndikuar shumë që cilësia e mësimit të rritet dhe bashkë me të edhe praktika e edukimit.
- Japonia, ndryshe nga vendet e botës së tretë, nuk është rreshtuar pas zërave që thërrasin për transferimin e kulturës së përgjithshme si përgjegjësi që do të promovohet nga mediat, përkundrazi, puna e

⁵⁵ Konsideroj se pikërisht këtu qëndron defekti në shkollat, institucionet dhe universitetet arabe, ngase në to nuk ka model, shëmbëlltyrë dhe kreativitet.

mbështetjes së kulturës së përgjithshme mbeti përgjegjësi e Ministrisë së Edukimit, Shkencave dhe Kulturës⁵⁶.

II. 3. IMAZHE NGA ETIKA E NXËNËSVE DHE MËSUESVE JAPONEZË SI DHE DISA ASPEKTE NEGATIVE TË SISTEMIT ARSIMOR NË JAPONI

1) Etika dhe edukata e nxënësve dhe mësuesve në Japoni

Brenda objektit shkollor nuk ka restorant. Ekziston një kuzhinë në të cilën përgatitet ushqimi për nxënës, nën përkujdesjen e një mësueseje. Nxënësit marrin çdo ditë ushqim të freskët dhe janë të ndarë në grupe⁵⁷. Njëri grup përgatit klasën për të ngrënë, tjetri sjell ushqimin, ndërsa i treti e shpërndan atë, kuptohet pasi që të kenë veshur rrobat përkatëse (kapelat dhe mantelet⁵⁸).

Qysh nga periudha e hershme e shkollimit, nxënësit ndajnë përgjegjësitë. Kujdestarët e klasave, detyrë e të cilëve është mbajtja e rendit në klasë, diskutimi i çfarëdo problemi etj., zëvendësohen kohë pas kohe, për t'ua mësuar kështu praktikisht artin e udhëheqjes⁵⁹.

Çdo nxënës ka mjetet e veta shkollore. Nxënësit i pastrojnë dhëmbët çdoherë pas ushqimit, siç do të mund ta shihni në shtojcë, ndërsa klasa është përplot moto dhe parulla stimuluese, si: *'Do japim mundim tonë maksimal për çdo gjë!', 'Bëhu aktiv, disponues, i dashur dhe ndihmëtar për tjerët!'*⁶⁰

⁵⁶<http://degrees.excite.com/education/programs/distance-learning/japanese-education-system/index.php>,

<http://eljaafaria.arabstar.biz/montada-f2/topic-t602.htm>

⁵⁷ <http://www.omraneya.net/node/120258>

⁵⁸ Shih fotot.

⁵⁹ Kthehu tek shtojca.

⁶⁰ <http://www.moeforum.net/vb1/showthread.php?t=160789>

Në tabelën më poshtë do të mundohemi të sqarojmë apo të ofrojmë krahasime ndërmjet dy sistemeve të ndryshme për të nxjerrë në shesh të vërtetën mbi palën e tretë, pra sistemin arsimor të vendeve arabe.

Kur mësuesi hyn në klasë, nxënësit ngrihen në këmbë dhe e përkulin kokën në shenjë respekti duke thënë: *'O mësuesi ynë, shpresojmë se do të jesh i mirë me ne dhe do të na mësosh!'* Është një respektim më shumë se i zakonshëm, ka një domethënie dhe botëkuptim shumë të hollësishëm për respektin e madh, andaj edhe perceptohet si krenar, madhështor, prandaj i atribuohet edhe mjekëve dhe parlamentarëve.

Siç kanë përmendur ekspertët, nxënësit japonezë kanë një takim që e quajnë 'Sesioni i pranimit (të gabimit)' ose 'Sesioni i llogaritjes shpirtërore dhe shoqërore', ku nxënësit llogarisin veten për punët e bëra gjatë ditës, ndërsa udhëheqësi i grupit të nxënësve parashtron këto pyetje:

- a. A i kryem detyrat tona siç është kërkuar? Të pranishmit përgjigjen: 'Po' ose 'Jo.'
- b. A e shfrytëzuar racionalisht kohën tonë? Nxënësit përgjigjen: 'Po' ose 'Jo.'
- c. A e kemi vendosur inventarin e klasës në vend? Nxënësit përgjigjen: 'Po' ose 'Jo', por zakonisht përgjigja është pozitive⁶¹.

Me gjithë respektin e madh që sistemi arsimor parasheh për mësuesin, prapë punohet në drejtim të asaj që kompetencat e mësuesit mbi nxënësit të jenë të pakta. Zërat dhe të qeshurat brenda klasës janë të larta, gjë kjo që nuk e pengon shumë mësuesin.

Analistët dhe ekspertët e edukimit kanë theksuar se pozita e mësuesit, jo vetëm në ambientet shkollore dhe jo vetëm në një periudhë mësimi, por në të gjitha periudha dhe nga e tërë shoqëria, perceptohet si e lartë.⁶²

Është traditë e mësuesve që t'i vizitojnë nxënësit e tyre nëpër shtëpi duke vënë kontakt me kujdestarët apo prindërit e nxënësit, të diskutojnë me ta

⁶¹ http://educationjapan.org/jguide/school_system.html

⁶² <http://eljaafaria.arabstar.biz/montada-f2/topic-t602.htm>

dhe të mbajnë lidhje nëpërmjet vërejtjeve që ata japin për provimet, detyrat e shtëpisë, sjelljet e nxënësve etj⁶³.

2) Aspektet negative të sistemit arsimor në Japoni

Sistemi arsimor në Japoni nuk është i përkryer. Edhe pse pëlqehet shumë, prapë ka të meta, sidomos në disa teori edukative. Imam Shafiu [*Allahu e mëshiroftë*] ka thënë: *'Kënaqësia e njerëzve është ideal që nuk arrihet!'* Kështu është puna edhe me këtë sistem, i cili nuk mund të shpëtojë dot nga vërejtjet, ngase, fundja, është prodhim i njeriut dhe njeriu gabon. Këto të meta apo vërejtje do të mund t'i përmbledhim siç vijon:

- a. Centralizimi strikt dhe fokusimi i tepërt në dije dhe mbamendje.
- b. Ngarkimi me detyra të rënda dhe provime të vështira për t'u regjistruar në shkolla të mesme të avancuara dhe në universitete, diplomimi në të cilat ofron mundësi të mira punësimi.
- c. Në Osaka, mesatarja e rënies në provime nga 2.5% sa ishte në vitin 1995 qe rritur në 3% në vitin vijues (1996).
- d. Shifra e nxënësve që punojnë natën në vend se të mësojnë është në rritje⁶⁴.
- e. Vetëvrasja, për shkak të dështimeve në provim, është dukuri në përhapje në mesin e nxënësve⁶⁵.

Pra, mund të konkludojmë se ky sistem, sado që të jetë i avancuar, përderisa është punë e njeriut, nuk mund ta arrijë përsosmërinë.

Muslimanët gjithsesi duhet të përvetësojnë aspektet pozitive të këtij sistemi dhe t'iu shmangen atyre negativeve, siç ishte rasti i vetëvrasjeve për shkak të dështimeve në provime etj.

⁶³ http://www.bab.com/articles/full_article.cfm?id=1594

⁶⁴ <http://www.iop.or.jp/0010s/kumagai.pdf>

⁶⁵ <http://www.biomedcentral.com/1471-244X/7/64>
<http://www.japaninc.com/jin418>

-III-

**BOTËKUPTIMET E MODERIMIT QË MUNGOJNË NË
SHKOLLAT DHE UNIVERSITETET ARABE,
NËPËRMJET KRAHASIMIT NDËRMJET SISTEMIT
ARSIMOR TË JAPONISË DHE AMERIKËS**

III.1. FUSHAT E DALLIMIT NDËRMJET ARSIMIT JAPONEZ DHE ATIJ AMERIKAN

Gjatë prezantimit të këtij krahasimi, me të cilin synojmë të zbulojmë gjendjen e vërtetë të sistemit arsimor arab, nuk do të ndalimi në detajet dhe hollësitë e këtij të fundit, për shkak se, siç kemi thënë, këtë tashmë e kanë të qartë të gjithë (se është sistem i dështuar) dhe siç është thënë: *'I mençuri (edhe) me shenjë kupton.'*

Ekspertët dhe analistët kanë përmendur një sërë fushash ku mund të vërehen dallimet ndërmjet sistemit japonez dhe atij amerikan:

- a. Diversiteti apo shumëllojshmëria përballë ngjashmërisë
- b. Decentralizimi përballë centralizimit
- c. Mësimi i obliguar
- d. Viti shkollor
- e. Jeta shkollore
- f. Fusha e metodologjisë mësimore
- g. Përgatitja e mësuesve⁶⁶.

Në këtë studim krahasimtar do të përqipem të përmend përgjithësisht aspektet më të rëndësishme, për t'u ndalur më pas në esencën e arsimit japonez dhe amerikan. Duke i analizuar këto dy sisteme do të na bëhet i qartë edhe sistemi arsimor në vendet arabe. Është synimi im, dhe e lus Allahun të jetë realizuar me këtë studim, që sistemeve tona arsimore t'u ofrojmë modele të dëshmuara për sukses, ngase siç është vërtetuar, Perëndimi i ka përvetësuar parimet e fesë sonë, por në një formë tjetër. Kush mund të thotë se *'drejtësia shoqërore, të drejtat e njeriut, liria individuale, etika e dialogut, përsosmëria e punëve, përmbajtja e takimeve...'* nuk janë pjesë e sistemit të përgjithshëm islam? Realisht, muslimanëve bashkëkohorë iu mungojnë shembuj të këtij zhvillimi.

⁶⁶ Edward R. Beauchamp, *Et-ta'lim el jabanijj ve-t-ta'lim el-emrikijj – dirasetun mukarenatun* (përkthyer në arabisht nga Prof. Muhammed Taha Alijj), f.14-62; Izetbegoviç, Alija, *El-Islamu bejnesh sherki vel garb*, f. 98-104.

Target grupi i këtij studimi janë universitetet arabe. Pra, nuk do të përmendim institucionet arsimore në vendet arabe, ngase, konsideroj se shumica e të pranishmëve në këtë konferencë janë në dijeni për to.

Nr.	Sistemi arsimor në Japoni	Sistemi arsimor në Amerikë	Botëkuptimet që mungojnë në universitetet arabe
1.	Bindjet dhe vlerat respektojnë konfuçionizmin.	Amerikanët nuk e bëjnë një gjë të tillë.	
2.	Respektimi i atyre që e vënë jetën në shërbim të dijes (mësuesve).	Të drejtat e individit parashohin që ai të mos i nënshtrohet askujt.	
3.	Kritere të ashpra kulturore për ambientim me kolektivin brenda kornizës shoqërore.	Barazia krah për krah me tjetrin duke ruajtur lirinë individuale.	
4.	Qytetarët janë të obliguar që të participojnë për një rend shoqëror, larg interesave individuale.	Qytetari amerikan ka të drejtën e shprehjes së mendimi për çfarëdo çështje, sado madhore të jenë ato. Shoqëria amerikane shquhet për spekulime të paskrupullta ideologjike dhe fetare.	Kjo domethënie e mesatares në sistemin arsimor japonez, pra 'Respektimi i rendit dhe ligjit' (pushtetarëve) është çështje e marginalizuar në vendet arabe.
5.	Interesimi për kolektivin dhe harmonizimin me të, duke i dhënë përparësi madje ndonjëherë edhe ndaj interesave individuale.	Individualizmi është dukuri e theksuar në SHBA.	Kjo domethënie e mesatares në sistemin arsimor japonez mungon në vendet arabe.
6.	Shoqëri me ngjashmëri të mëdha. Janë nga një racë dhe kanë burim kulture të unifikuar. Në fakt, kanë edhe grupe fetare	Shoqëria amerikane është e pluralizuar. Për shkak të refugjatëve të shumtë, janë detyruar që t'i kushtojnë rëndësi dy gjërave: gjuhës dhe kulturës pluraliste.	

	të ndryshme, vetëm se anojnë nga tolerimi dhe lehtësimi, gjë që japonezëve iu ka dhënë një imazh kolektiv të fortë. Ata i urrejnë pakicat, siç janë p.sh. koreanët.		
7.	Disponon një sistem arsimor të centralizuar, të ngjashëm me atë të tipit francez dhe gjerman, dhe i cili i qëndron besnik programeve të vëna nga Ministria dhe Qeveria Qendrore Japoneze.	Jobesnikëria ndaj qeverisë qendrore. Kjo punë i është besuar qeverive lokale, që nënkupton se ka hapësirë për programe të ndryshme dhe treg të hapur e fitimprurës për libra shkollorë.	Ky botëkuptim i lojalitetit, por edhe ky centralizim, siç është në Japoni, mungon në vendet arabe. Besnikëria në Ministri është relative.
8.	Ministria e Arsimit është ajo që përcakton edhe detajet e programit mësimor. Pa lejen paraprake nga ministria nuk mund të mësohet asnjë libër në shkolla. Pavarësisht se ku jeton nxënësi, në Tokio, Osaka apo Saporu, atij i garantohet program i njëjtë, me cilësi dhe nivel të njëjtë.	Decentralizimi ka sjellë një sistem që financimin e shkollave nuk e bën në mënyrë proporcionale. Metodologjitë mësimore dallojnë dhe, për shkak të kësaj, në njëfarë mënyre, nxënësit i ofrohen kushte mësimi varësisht nga ambienti ku ka lindur e ku jeton.	Në vendet arabe mund të haset një mungesë relative e kësaj domethënieje të unifikimit të idesë dhe programeve.
9.	Kontrollimi qeveritar, sidomos në librat e historisë dhe të shkencave shoqërore, apo	Defektet e decentralizimit amerikan janë evidente, për shkak të përcaktimit të librave dhe programeve arsimore.	

	<p>librave që mund të jenë në kundërshtim me traditat dhe kulturën e vendit. Këtë e bëjnë që krahu majtist në politikë të mos ketë shumë hapësirë për të përhapur idetë e veta, duke iu përmbajtur parimit <i>'paanshmëri arsimore.'</i></p>	<p>Shtetet e fuqishme, si Nju Jorku, Kalifornia, Teksasi, për shkak të fuqisë ekonomike, kanë ndikim të madh në përcaktimin përmbajtjesor të librave dhe programeve arsimore.</p>	
10.	<p>Shteti i obligon nxënësit që të qëndrojnë në shkollë deri në moshën 15 vjeçare, apo së paku deri në mbarimin e klasës së nëntë (9), por 94% e japonezëve e vazhdojnë edhe shkollën e mesme trevjeçare, edhe pse nuk e kanë obligim.</p>	<p>Në SHBA kërkohet që nxënësit të qëndrojnë në shkollë deri në moshën 16 ose 18 vjeç. Megjithëkëtë, shifra e atyre që kryejnë shkollën e mesme është më pak se 8 në 10 nxënës. Pjesa tjetër kalojnë disi apo i përsërisin klasat para diplomimit.</p>	<p>Ky botëkuptim i qëndrueshmërisë së programit mësimor, veçimit dhe qendrës (kontrollimit nga qendra) mungon në botën arabe.</p>
11.	<p>Shkolla ua ndalon nxënësve punën <i>'part time.'</i></p>	<p>Për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit, nxënësit angazhohen pas orarit mësimor në punë të ndryshme.</p>	<p>Edhe ky botëkuptim mungon në tokat arabe. Nxënësi apo studenti është i obliguar madje me punë të rënda, ndryshe nuk mund të mbijetojë.</p>
12.	<p>Shkolla ua kushtëzon nxënësve veshjen e rrobave të njëjta, ndërsa nxënëset i ndalon të përdorin makijazhe, madje edhe</p>	<p>Shkollat dhe universitetet nuk kanë uniforma.</p>	<p>Kjo domethënie e qëndrueshmërisë së programit, sigurisë dhe largimit nga rreziqet mungon në vendet arabe.</p>


	<p>flokët i kanë të ndara njësoj, ashtu siç bëjnë me fëmijët.</p> <p>Shkollat e mesme ua ndalojnë nxënësve që të frekuentojnë baret apo klubet e natës, kazinotë etj. Shkolla është e para ajo që lajmëron policinë në rast të ndonjë problemi.</p>		
13.	<p>Posedimi i veturës nën moshën 18 vjeçare nuk lejohet. Nxënësit nuk i lejohet të shkojnë në shkollë me veturë. Edhe pse ligji e lejon posedimin e motoçikletave në moshën 16 vjeçare, prapë disa shkolla ua ndalojnë nxënësve të shkojnë me to në shkollë.</p>	<p>Plotësisht e kundërta.</p>	<p>Ky botëkuptim i sigurisë dhe ruajtjes nga rreziqet mungon totalisht në vendet arabe.</p>
14.	<p>Nxënësit japonezë e shohin mësimin si profesion, andaj çdokush që nuk është në moshën madhore, duhet ta bëjë këtë punë. Metodologjinë japoneze e vënë në lëvizje tri elemente:</p> <p>1) Mbjellja e vlerave,</p>	<p>Shkollat amerikane janë shndërruar nga institucione akademike në institucione të gjera shoqërore. Ato janë vende argëtimi në të cilat ushqimi servohet falas, jepen këshilla kundër dukurive negative etj. Po kështu, disa grupe dhe lëvizje që përkrahin disa çështje të</p>	<p>Universitetet dhe institucionet arabe vuajnë nga mungesa e këtyre domethëniesve të ruajtjes së mesatares, që u përmendën në sistemin japonez.</p>

	<p>virtyteve dhe tipare shoqërore në gjeneratat e reja</p> <p>2) Përgatitja e nxënësve për provime të vështira, për t'i bërë të denjë të kalojnë në shkallë të larta</p> <p>3) Përmbushja e kërkesave të komunitetit të biznesit.</p> <p>Kjo dëshmon pse metodologjia japoneze është e suksesshme. Ndoshta për këtë i detyrohen edhe mënyrës së mësimdhënies, e cila është unike, ngase përcaktohet nga Ministria dhe vlen për periudhën parashkollore e deri në shkollën e mesme.</p>	<p>interesit kombëtar kanë ndikim të madh në formësimin e programeve shkollore, siç është ngasja e veturave, edukimi seksual, vetëdijesimi karshi drogës, varësia nga alkooli, mbrojtja nga AIDS-i, bashkëjetesa ndërmjet komuniteteve etj.</p>	
15.	<p>Nxënësit japonezë janë ambiciozë për t'u regjistruar në fakultete, me gjithë konkurrencën e madhe që është. Edhe gjatë vikendeve e kalojnë kohën në shkolla e institute për t'u përgatitur sa më mirë për</p>	<p>Nxënësit amerikanë janë plotësisht në kundërshtim me këtë.</p>	<p>Prania e kësaj gjendjeje në universitetet arabe është relative dhe dallon nga vendi në vend.</p>

	<p>provim. Nxënësit janë shumë të lidhur me shkollën dhe nuk ndiejnë kurrë monotoni prej saj.</p>		
16.	<p>Librat shkollorë janë të formatit të vogël dhe janë me fletë të lidhura. Nuk jepen shumë sqarime dhe nxënësi ka të drejtë t'i bartë ato në shtëpi.</p>	<p>Librat amerikanë dallojnë shumë në format dhe përmbajtje. Zakonisht janë të formatit të madh dhe janë përplot sqarime e shpjegime me foto dhe harta. Tekstet, ndryshe nga ato japoneze, janë të thjeshta ndërsa nxënësi nuk ka të drejtë t'i marrë me vete në shtëpi. Ata kanë dollapët e tyre të veçantë për libra, gjë që në krahasim me metodën japoneze, është më e kushtueshme.</p>	
17.	<p>Lëndët zgjedhore në Japoni janë shumë pak.</p>	<p>Në SHBA, sipas studimeve të fundit, vetëm 55% e programeve apo kurseve mësimore janë obligative, ndërsa të tjerat janë zgjedhore.</p>	
18.	<p>Pushimi veror nuk është thjesht pushim. Nxënësit janë të ngarkuar me detyra, kryerja e të cilave kërkon mund të madh.</p>	<p>Pushimi veror në shkollat amerikane është deri në tre muaj, duke i shtuar kësaj edhe pushimet për festa, si për Vitin e Ri, festat kombëtare etj.</p>	<p>Përsosmëria dhe kreativiteti janë botëkuptime që mungojnë në shkollat dhe universitetet arabe.</p>

<p>Ndonjëherë ngarkohen me nisma, që obligojnë edhe familjen për pjesëmarrje. Nxënësi japonez merr mësim më shumë se homologu i tij amerikan për 3-4 vite. Nxënësi japonez i shkollës së mesme jep shumë më tepër mund se sa një nxënës amerikan.</p>	<p>Mesatarisht, ka 180 ditë mësimi, me përjashtime, kur për shkak të acarit ose të ndonjë shkakut tjetër, nuk mbahet mësimi.</p>	
---	--	--

SHTOJCA ME FOTO



Në rast se mësuesi mungon, ai nuk ka zëvendësues. Këtë e bën vetë klasa, duke përsëritur mësimet e marra më herët apo duke kryer obligimet dhe detyrat që kanë.

PASQYRIMI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE TË SHKOLLËS FILLORE HIGASHI NË HAMAMATSU CITY



Zakonisht, nxënësit shkojnë në shkollë të organizuar në grupe dhe mbajnë kapela për t'i mbrojtur nga fatkeqësitë e mundshme dhe rreziqet. Siç shihet, janë në përkujdesjen e prindërve ose mësueseve.



Në hyrje të ndërtesës shkollore, të gjithë nxënësit i zbathin këpucët dhe i heqin kapelat. Ato i vendosin në rafte të caktuara, me emër dhe numër për të gjithë ata.



Nxënësit gjatë një ore mësimi duke mësuar shkronjat e alfabetit japonez. Siç mund të vërehet, secili nxënës ka ngjyrën dhe pendën e veçantë për shkrim dhe ushtrime.



Mëngjesin dhe drekën i hanë në shkollë, në kuzhinat përkatëse, nën përkujdesjen e personelit përkatës.



Pas përfundimit të ushqimit, nxënësit pastrojnë kuzhinat dhe klasat me dorë, punë kjo që e bëjnë çdo ditë.



Nxënësit, po kështu, pastrojnë bashkërisht edhe dyshemenë e klasave.



Pastrimi i enëve nga nxënësit pas ngrënies.



Pamje nga brendësia e klasës, ulëset dhe raftet për vendosjen e çantave.



Pas ngrënies së ushqimit, pastrojnë dhëmbët dhe rregullohen (flokët, lajnë fytyrën etj.) për t'u kthyer më pas në klasë.



Nxënësit në laboratorin kompjuterik.

PASQYRIMI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE TË SHKOLLËS SË MESME PËR JUNIOR NANYO NË HAMAMATSU CITY



Nxënësit nuk kanë të drejtë të ngasin vetura pa mbaruar shkollën e mesme. Ata vijnë në shkollë me biçikleta ose motorë të vegjël. Sikurse edhe në shkollat fillore, edhe këta kanë raftet për këpucë dhe për të mbathura të veçanta për të hyrë në tualet.



Ushtrimi i nxënësve për t'u përkujdesur për ambientin dhe gjelbërimin. Ky është aspekti praktik i asaj çfarë kanë mësuar në teori përkitazi me ambientin. Në këtë periudhë mësimi, nxënësit mësojnë për gjëra që kanë të bëjnë me ambientin, ndërsa në periudhat në vijim, në të mesmen e ulët mësojnë për shëndetin dhe interesin publik, ndërsa në të mesmen e lartë mësojnë për çështje të mëdha në nivel ndërkombëtar.



Përgatitja e ushqimit në shkollë. Nxënësve nuk iu lejohej që të sjellin ushqim nga shtëpia ose të blejnë. Ushqimi përgatitet në shkollë dhe është i shquar për vitaminat dhe kaloritë.



Nxënësit hanë ushqim në klasa, ndërsa kuzhinieret, siç shihet në foto, kujdesen maksimalisht për veshjen e tyre në mënyrë që të mos depërtojnë baktere a ndonjë papastërti eventuale në ushqim.



Pastrimi me rend i kuzhinës nga nxënësit.



Aktivite të lira pas mësim. Shumica e nxënësve marrin pjesë në këso lloj aktivitete që, përveç sportit, kanë edhe karakterin e shtimit të njohurive të reja.

PASQYRIMI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE TË SHKOLLËS SË MESME SHIZOUKA NË HAMAMATSU CITY



Edhe në këtë periudhë shkollimi, nxënësit i zbathin këpucët dhe veshin të tjera me rastin e mësimit. Ata përdorin biçikleta dhe motoçikleta ngase nuk iu lejohet ngasja e makinave. Shkollat nuk ua sigurojnë udhëtimin.



Interesimi i nxënësve të shkollave të mesme për kompjuterin është jashtëzakonisht i madh.



Nxënësit i kushtojnë rëndësi edhe mësimit të shkrimit tradicional të tyre dhe secili ka penën dhe ngjyrën e vet.



Nxënësit pastrojnë klasat dhe shkollën.



Pas ushqimit, nxënësit pastrojnë klasat ngase nuk ka kuzhina. Atyre nuk iu lejonet të dalin jashtë për ushqim, por, për dallim nga periudhat e mëparshme, iu lejonet që të sjellin ushqim nga shtëpia.



Pas mbarimit të mësimit, nxënësit ndalen për ushtrime dhe aktivitete sportive, siç janë sportet luftarake që shihen në këto foto.

Përfundim

Falënderimet i takojnë Allahut, me dhuntitë e të Cilit plotësohen të mirat dhe realizohen qëllimet fisnike! Përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin, krijesën më të zgjedhur dhe vulën e peygamberëve, mbi familjen, shokët dhe pasuesit e tij!

Falë ndihmës së Allahut, arritëm në përfundimin e këtij studimi. Lutem tek i Madhi Allah që ky studim të jetë një kontribut përkrah kontributeve edukative të mendimtarëve dhe edukatorëve para meje. Nuk pretendoj të kem mbuluar dhe përfshirë të gjitha aspektet e temës. Ajo çka unë jam munduar të bëj ka qenë ofrimi i një ideje të studiuar, të cilën e kam parë si të dobishme për të rregulluar gjendjen tonë arsimore në shkollat dhe universitetet arabe. Jam orvatur të promovoj vlerat e mesatares islame, gjithnjë sipas Kur'anit dhe Sunnetit, të cilat për fat të keq i mungojnë shoqërive tona, duke ofruar modele të disa prej përvojave dhe kulturave të dëshmuara si të suksesshme, kuptohet përderisa këto nuk ndeshen me parimet tona fetare.

Sinqerisht, nuk them se kam arritur me të mirën të mundshme, edhe pse jam përpjekur. Kështu, nëse unë ia kam qëlluar të vërtetave, kjo është dhuratë prej Allahut, e nëse kam gabuar, kjo është shkak i harresës dhe gabimeve njerëzore, andaj të gjitha këshillat, sugjerimet dhe vërejtjet metodologjike janë të mirëseardhura.

Krejt për fund, dëshiroj të tërheq vëmendjen e lexuesve të nderuar se ndoshta ky studim teorik mund të duket paksa i vështirë pa konkretizimin e tij, qoftë nëpërmjet një filmi dokumentar apo një vizite në Japoni, për të parë nga afër procesin arsimor atje. Për fatin tonë të mirë, profesor Ahmed Shukajri nga Arabia Saudite, i cili në programin e tij të njohur, *'Havatir*, nr. 5' (Mendime) i prezantoi të gjitha këto aspekte kulturore dhe shkencore të shoqërisë japoneze në formë filmimesh të xhiruara në Japoni. Jam gëzuar shumë kur kam hasur programin e tij, ani pse isha në fund të përgatitjes së këtij punimi. Në fakt, programi i tij qe mbajtur afërisht një vit (2009) para se unë ta filloja këtë studim (2010), por unë i ftoj të gjithë lexuesit, që

krahas leximit, të shikojnë edhe këto 30 emisione, ngase janë vërtet të dobishme⁶⁷.

E lus Allahun që të ma pranojë këtë studim dhe ta vendosë atë në peshoren e veprave të mia të mira në ditën kur nuk të bën dobi asgjë, përveç veprës së mirë.

Përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij!

Lutja jonë e fundit është:

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Dr. Hajredin Hoxha

11.10.2010

Brunei Darussalam

⁶⁷ http://www.youtube.com/watch?v=AQkQNhaU5mE&feature=rec-LGOUT-real_rn-1r-6-HM

Bibliografia

1. Ahmed, Semir Abdul Hamid el-Kutb, *Dhahiretu unfi-sh-shebab fil muxhtemeil arabijj: esbabuha ve subulu ilaxhiha min mendhurin terbevijjin – dirasetun mes'hijjetun*, Konferenca ndërkombëtare 'Esh-Shebab el-xhamiij vet tesaddi lil irhab, Univeristeti Tajjiba në Medine Munevvere, 2004.
2. Edward R. Beauchamp, *Et-ta'lim el jabanijj ve-t-ta'lim el-emrikijj – dirasetun mukarenetun* (përkthyer në arabisht nga Prof. Muhammed Taha Alij), *Es-silsiletu el alemijjetu li-t-ta'lim*, b.2, Rijad, 2002.
3. Edward R. Beauchamp, *Et-terbijjetu fil Jaban el musaireh* (përkthyer në arabisht nga Muhammed Abdul Halim Mersi), *Mekteb et-terbijjeti el-arabijj li-d-duveli el-halixh*, Rijad, 1406 h.
4. Albani, Muhammed Nasiruddin, *Daifu Suneni Ebi Davud*, *El-mekteb el-islamijj fi Bejrut*, b.1, 1408 h.
5. Badehdah, Ali Umer dhe të tjerë, *Eth-thekafetu el-islamijjeh*, Daru Hafidh, b.1, 1425 h.
6. Balamesh, Fejsal Seid dhe të tjerë, *Eth-thekafetu el-islamijjeh*, niveli 3, Universiteti Mbreti Abdul Aziz, Qendra e botimeve, Xhiddeh, b.1, 2007.
7. Bekar, Abdul Kerim, *Asruna vel ajshu fi zemanhis sa'b*, Darul kalem, b.2, Damask, 2004.
8. Izetbegović, Alija, *El-Islamu bejnesh sherki vel garb*, b.1, Mexhelletu en nur el kuvejtijjeh, 1994.
9. Haseneh, Umer Abiid, *Etth thekafetu el matlubetu hatta nekune fi musteva islamin*, El mekteb el islamijj, Bejrut, b.1, 2006.
10. Es sijasetu et-ta'limijjeh lil Memleketil Arabijjetis Suudijjeh, el-hedef nr. 27.
11. Esh-shumejmiri, Ahmed Ibn Abdurrahman, *Kejfe tekun muderrrisen naxhihan – 330 nesihatun lil muderr-risine vel muderr-rrisat*, Darul Mexhd, b.1, 1415, Rijad.

12. Ulvan, Abdullah nasih, *Esh-shebab el muslim fi muvaxhehetit tehaddijat*, b.4, 2002, Darul Kalem, Damask.
13. Gazali, Muhammed, *Sirr-rru te'hiril arab vel muslimine*, Darul Kalem, Damask, b. 2, 2005.
14. Gazali, Muhammed, *Dusturu el vihdeti-th-thekafijeti*, b.4, Darul kalem, 2003.
15. Kardavi, Jusuf, *el-Hasais el amme lil Islam*, Muesseseturr Rrisale, b. 10, 1997.
16. Kardavi, Jusuf, *Thekafetud daijeh*, Mektebetu Vehbe, b. 13, 2004, Kajro.
17. Kardavi, Jusuf, *Thekafetuna bejnel infitahi vel ingilak*, b.2, 2005, Darush Shuruk.
18. Kejlani, Maxhid Urgan, *Et terbijjetu vet texhdid ve tenmijjetul failijjeti indel muslimil muasir*, b.1, 1997, Muesseseturr Rrejjan, Bejrut.
19. Revista *el-Hikme*, Maçester, Britani dhe Meidne, nr. 37, 'Dhahiretul irhabi bejnet teshhisi vel ilaxh', 1429 h.
20. Revista *el-Emn*, nr. 16, Ministria e Brendshme, Saudi, 1419 h.
21. El-Mursafi, Sa'd, *Eth-thekafetul islamijeh ve etheruha fi tekvinish shahsijjetil islamijeh*, Darul Jekin, Mensure, b. 1, 2004.
22. Mustafa, Muslim, *Eth-thekafetu el islamijeh - ta'rifuha, mesadiruha, mexhalatuha, tehaddijatuha*, Darul Beshir, EBA, b.1, 2004.
23. Nahlavi, AbduRrahman, *Usulu-t-terbijjetil islamijeti ve eslaibuha fil bejti vel emdreseti vel muxhtemeë*, b.1, Darul Fikr, Damask.
24. Hindi, Salih dhe të tjerë, *Eth-thekafetul islamijeh*, Darul Fikr, Amman, b.2, 2000.
25. Yalçin, Mikdad, *Et-terbijjetul islamijetu vet tabiatul insanijeh*, b.2, 2002, Daru alemil kutub, Rijad.
26. Yalçin, Mikdad, *Terbijjetul exhjal ala ahlakijjati ve adabil munakasheti vel muhavereti vel munadharetil ilmijeh*, Daru alemil kutub, b. 1, 2004.

27. Yalçın, Mikdad, *Subul en-nuhud bit tul-lab hulukijjen ve ilmijen ila musteva ehdafil ummeti*, b.1, 1999, Daru alemil kutub, Rijad.
28. Yalçın, Mikdad, *Devru et terbijjeti el ahlakijjeti el islamijjeti fi binail ferdi vel muxhtemei vel hadaretil insanijjeti*, Daru alemil kutub, 1416.
29. James J. Shileds; *Japanese Schooling: Patterns of Socialization, Equality and Political Control*, 3rd ed. The Pennsylvania State University Press, 1993
30. Robert, Albanese; *Managing: Toward Accountability for Performance*, 3rd ed, Homewood, Illions, 1981, pg: 16.
31. Peak, Lois; *Learning to go to School in Japan Berkely & Los Angeles*, University of California Press, 1991.
32. <http://www.alshref.com/vb/t115785.html>
33. <http://www.mohyessin.com/forum/showthread.php?t=6667>
34. <http://www.garndabi.com/vb/showthread.php?t=4226>
35. http://www.ibe.unesco.org/fileadmin/user_upload/archive/Countries/WDE/2006/ASIAandthe_PACIFIC/Japan/Japan.pdf
36. <http://home.hiroshima-u.ac.jp/cice/JEF2report1e.pdf>
37. http://www.studyinJapan.org.my/04_study/04_study2_qna.html
38. http://www.saudiembassy.or.jp/Ar/Education/Ed_n_jp_Car.htm
39. <http://degrees.excite.com/education/programs/distance-learning/japanese-education-system/index.php>
40. <http://eljaafaria.arabstar.biz/montada-f2/topic-t602.htm>
41. [www://thawra.alwahda.gov.sy](http://www.thawra.alwahda.gov.sy)
42. <http://www.omraneya.net/node/120258>
43. <http://www.moeforum.net/vb1/showthread.php?t=160789>
44. http://educationjapan.org/jguide/school_system.html
45. http://www.bab.com/articles/full_article.cfm?id=1594
46. <http://www.iop.or.jp/0010s/kumagai.pdf>

47. <http://www.ksu.edu.sa/sites/ksuarabic/research/ncys/pages/c.aspx>
48. http://www.youtube.com/watch?v=AQkQNhaU5mE&feature=rec-LGOUT-real_rn-1r-6-HM